

**Mishngrënësit e mëdhenj në Alpet  
Dinarike:  
Menaxhimi, monitorimi,  
kërcënimet dhe konfliktet**

**Krijimi i platformës së shkëmbimit në nivel  
ndërkombëtar  
për menaxhimin e mishngrënësve të mëdhenj  
në Rajonin Dinarik  
– Raport informues–**



**Katrina Marsden  
Andrea Solić  
Djuro Huber  
Christiane Röttger  
Iven Froese  
Julia Schmidt**

**Fotografia në kopertinë:** Ariu i murrmë në Rajonin Dinarik (© D. Huber).

**Autorë:**

Katrina Marsden  
Christiane Röttger  
Iven Froese  
Julia Schmidt

adelphi research gemeinnützige GmbH  
Alt-Moabit 91, 10559 Berlin Email:  
Email: marsden@adelphi.de  
roettger@adelphi.de  
froese@adelphi.de  
schmidt@adelphi.de

Andrea Solić  
Prof. Djuro Huber

Carnivora Magna,  
Ul. Slavka Kolara 45/B, 10410, Velika Gorica, Kroaci  
Email: andrea4nature@gmail.com  
djuro.huber@gmail.com

**Mbikëqyrëse:**

Katharina Steyer

Agjencia Federale Gjermane për Ruajtjen e Natyrës (BfN)  
Sektori II 1.1: Ruajtja e botës së egër  
Konstantinstraße 110, 53179 Bon, Gjermani  
Email: Katharina.Steyer@bfm.de

Sonja Otto

Agjencia Gjermane e Mjedisit (UBA)  
Sektori I 1.2 Strategjitë ndërkombëtare të qëndrueshmërisë, politikat dhe transferimi i njohurive;  
Programi i Asistencës Këshillimore (AAP) i Njesisë së Shërbimit të Projekteve  
Wörlitzer Platz 1, 06844 Dessau-Roßlau, Gjermani  
Email: Sonja.Otto@uba.de

Ky projekt është financuar nga Ministria Federale Gjermane e Mjedisit, përmes Programit të Asistencës Këshillimore (AAP) për mbrojtjen e mjedisit në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, në Kaukaz dhe në Azinë Qendrore, si dhe në vendet fqinje të Bashkimit Evropian. Projekti është mbikëqyrur nga Agjencia Federale Gjermane për Ruajtjen e Natyrës (BfN) dhe nga Agjencia Gjermane e Mjedisit (UBA).

Ky dokument është përkthim i botimit të mëposhtëm: Large Carnivores in the Dinarides: Management, Monitoring, Threats and Conflicts <https://www.bfn.de/sites/default/files/2022-02/Skript617.pdf>

Botues: Bundesamt für Naturschutz (BfN)  
Agjencia Federale Gjermane për Ruajtjen e Natyrës  
Konstantinstrasse 110  
53179 Bon, Gjermani  
URL: <http://www.bfn.de>

Botuesi nuk garanton saktësinë, detajet dhe plotësinë e deklaratave dhe pikëpamjeve të këtij raporti, dhe as respektimin e të drejtës së privatësisë së palëve të treta. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë ato të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e botuesit.



Kjo seri shpërndahet sipas kushteve të shpërndarjes së licencës së të drejtave të autorit "Creative Commons" - Vepra nuk mund të modifikohet, sipas "NoDerivatives 4.0 International" (CC BY - ND 4.0) (<https://creativecommons.org/licenses/by-nd/4.0/deed.en>).

ISBN 978-3-89624-378-2

DOI 10.19217/skr617

Bon, Gjermani 2021



## **Tabela e përmbajtjes**

<b>Tabela e përmbajtjes</b> .....	<b>5</b>
<b>Lista e figurave</b> .....	<b>6</b>
<b>Lista e tabelave</b> .....	<b>7</b>
<b>Përmbledhje</b> .....	<b>8</b>
<b>1 Historiku</b> .....	<b>9</b>
1.1 Objektivi dhe masat e planifikuara .....	10
1.2 Qëllimi i këtij raporti.....	10
<b>2 Prezantim me rajonin</b> .....	<b>11</b>
2.1 Mishngrënësit e mëdhenj në Alpet Dinarike .....	11
2.2 Kuadri institucional dhe faktori i anëtarësimit në BE .....	13
2.3 Mësimet nga përvojat e BE-së rreth bashkëjetesës me mishngrënësit e mëdhenj	17
<b>3 Metoda e mbledhjes së informacionit</b> .....	<b>21</b>
<b>4 Rezultatet</b> .....	<b>22</b>
4.1 Statusi i popullatës .....	22
4.2 Legjislacioni dhe statusi i gjuetisë .....	23
4.3 Monitorimi.....	24
4.4 Planet e menaxhimit.....	25
4.5 Kërcënimet kryesore ndaj popullatave të mishngrënësve të mëdhenj .....	26
4.6 Konfliktet kryesore.....	29
4.7 Mbrojtja dhe kompensimi i bagëtive .....	29
4.8 Nismat ekzistuese ndërkufitare.....	31
<b>5 Diskutime, hapat pasardhës dhe perspektiva</b> .....	<b>35</b>

## Lista e figurave

Figura 1: Shpërndarja e arinjve përgjatë Alpeve Dinarike (2012-16). Prania paraqitet në përmasat 10x10 km në shkallën evropiane LAEA-ETRS89 (Kaczensky et al. 2021). .....	11
Figura 2: Shpërndarja e ujkut përgjatë Alpeve Dinarike (2012-16).....	12
Figura 3: Shpërndarja e rrëqebullit përgjatë Alpeve Dinarike (2012-16). Ngjyra blu tregon praninë e përhershme, ndërsa ngjyra gurkali praninë sporadike.....	12
Figura 4: Masat për mbrojtjen e bagëtive (rrethimi dhe qeni i stanit; Autorja e fotos: Irena Kavčič).....	18
Figura 5. Ekipet e ndërhyrjes për arinjtë, të vendosura në disa vende të BE-së, duke përfshirë Kroacinë (Autori i fotos: Djuro Huber).....	19
Figura 6. Në anëtare e ekipit të ndërhyrjes duke liruar ariun nga kurthi i një gjahtari pa leje (Autori i fotografisë: Josp Kusak).....	28
Figura 7: Ruajtja e bagëtive nga qentë e stanit (Autori i fotos: Djuro Huber). .....	30

## **Lista e tabelave**

Tabela 1: Statusi i anëtarësimit në BE.....	14
Tabela 2: Statusi dhe tendenca e popullatës .....	22
Tabela 3: Gjuetia përgjatë Alpeve Dinarike.....	23
Tabela 4: Monitorimi përgjatë Alpeve Dinarike.....	24
Tabela 5: Planet e menaxhimit në Alpet Dinarike.....	26
Tabela 6: Kërcënimet kryesore. ....	27
Tabela 7: Konfliktet lidhur me praninë e MM-ve.....	29
Tabela 8: Kompensimi dhe mbrojtja.....	30
Tabela 9: Projektet dhe programet në rajon.....	32
Tabela 10: Nismat në rajon.....	34
Tabela 11: Hapat pasardhës për tematikat e platformës. ....	35

## Përmbledhje

Rajoni Dinarik në Ballkanin Perëndimor është një nga rajonet me larminë më të madhe biologjike në Evropë. Ky rajon është gjithashtu habitati i tri specieve mishngrënëse të mëdha: ariu, ujku dhe rrëqebulli (rrëqebulli i Ballkanit dhe i Euroazisë), që gjenden ndërmjet shteteve anëtare dhe joanëtare të BE-së.

Duke marrë parasysh larminë e madhe të këtyre specieve, sugjerohet koordinimi ndërkombëtar për menaxhimin e tyre, për të mundësuar ruajtjen në planin afatgjatë. Deri në ditët e sotme, është ndërmarrë vetëm një numër i vogël nismash ndërkufitare për sa i përket tematikës së projektit, midis qeverive përkatëse.

Për këtë arsye, projekti i Asistencës Këshillimore synon të krijojë një platformë shkëmbimi në nivel ndërkombëtar për menaxhimin e mishngrënësve të mëdhenj me pjesëmarrjen e tetë vendeve, që janë pjesë e Rajonit Dinarik: Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Kroacisë, Kosovës\*<sup>1</sup>, Malit të Zi, Maqedonisë të Veriut, Serbisë dhe Sllovenisë. Në vazhden e takimeve të ndryshme për platformën, administratat kombëtare do të bashkëpunojnë me grupet e tjera përkatëse të interesit nga sektori i bujqësisë, shkencës, gjuetisë dhe ruajtjes së natyrës për të zhvilluar së bashku parimet udhëzuese për bashkëpunim në të ardhmen. Sekretariati i platformës do të garantojë udhëheqjen e barabartë të aktiviteteve të projektit.

Ky raport informues vlerëson situatën e statusit aktual të mishngrënësve të mëdhenj, menaxhimin dhe monitorimin e tyre, kërcënimet dhe konfliktet në Rajonin Dinarik. Ai paraqet një përmbledhje të situatës në secilin vend dhe e krahason atë me vlerësimet e mëparshme.

---

<sup>1</sup> Të gjitha referencat ndaj Kosovës\* në këtë dokument, qoftë ndaj territorit, institucioneve apo popullsisë së saj, interpretohen pa cenuar pozitat lidhur me statusin, dhe janë në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për deklaratën e pavarësisë së Kosovës.

## 1 Historiku

Alpet Dinarike në Ballkanin Perëndimor përbëjnë një nga rajonet me larminë më të madhe biologjike në Evropë dhe janë habitat i tri specieve mishngrënëse të mëdha: ariut, ujkut dhe rrëqebullit. Duke marrë parasysh larmishmërinë e madhe të këtyre specieve, sugjerohet koordinimi ndërkombëtar për menaxhimin e tyre, për të mundësuar ruajtjen në planin afatgjatë. Deri më sot, në rajon ekziston vetëm një numër i vogël nismash ndërkufitare për menaxhimin e mishngrënësve të mëdhenj, megjithatë është e qartë që kërkohet një angazhim më aktiv lidhur me këtë aspekt.

Në vitin 2018, Platforma e BE-së për bashkëjetesën midis njerëzve dhe mishngrënësve të mëdhenj<sup>2</sup> - një grup organizatash që përfaqësonin interesa të ndryshëm lidhur me ruajtjen dhe menaxhimin e mishngrënësve të mëdhenj - organizuan një seminar të përbashkët me partnerët, në Budva të Malit të Zi<sup>3</sup>. Në përfundim të seminarit, pjesëmarrësit nënshkruan një deklaratë të përbashkët<sup>4</sup>, në të cilën kërkohet krijimi i një platforme të shkëmbimit në nivel ndërkombëtar, për menaxhimin e mishngrënësve të mëdhenj, në Alpet Dinarike (Kutia 1). Ata renditën edhe objektivat kryesorë, të platformës së shkëmbimit të mishngrënësve të mëdhenj. Këto objektiva bazohen në punën shumëvjeçare, të ekspertëve të rajonit për krijimin e dialogut/shkëmbimit në nivel ndërkombëtar. Kjo tregon qartazi interesin e përfaqësuesve të shteteve, shkencëtarëve, OJQ-ve dhe grupeve të interesit, për një qasje me pjesëmarrje midis vendeve.

### **Kutia 1: Marrëveshja e Budvës**

Pjesëmarrësit identifikuan objektivat e mëposhtme si prioritet për diskutimet paraprake mbi platformën:

1. Koordinimi dhe shkëmbimi i informacionit, për praktikatat e menaxhimit, politikatat dhe qasjet në rajon, duke përfshirë planet e menaxhimit në nivel kombëtar dhe rajonal, me synimin për të përmbushur objektivat në nivel popullate;
2. Mbështetje për rrjetëzim ndërkombëtar dhe shkëmbimin e përvojave, midis grupeve kyçe të interesit dhe autoriteteve;
3. Ngritja e kapaciteteve për detyrat menaxhuese lidhur me mishngrënësit e mëdhenj;
4. Bashkëpunim i shtuar ndërkufitar për monitorimin, si p.sh. mbi metodat dhe protokollet e standardizuara;
5. Krijimi i projekteve të tjera ndërkufitare, në mbështetje të objektivave të mësipërme;
6. Mbledhja e fondeve dhe gjetja e burimeve konkrete financiare, për të mbështetur aktivitetet dhe masat konkrete të nevojshme për platformën e ardhshme.

Në mënyrë që projekti të jetë i suksesshëm, nevojitet ndërmjetësim asnjans dhe kapacitete njerëzore, e financiare, për të mbështetur krijimin e platformës dhe përcaktimin e parimeve udhëzuese për bashkëpunim në të ardhmen. Për arritjen e këtyre objektivave, pjesëmarrësit ftojnë dhe nxisin autoritetet menaxhuese në Shqipëri, Bullgari, Bosnjë-Hercegovinë, Kroaci, Maqedoni e Veriut, Greqi, Kosovë\*, Mal të Zi, Serbi dhe Slloveni, që të bazohen në përfundimet e arritura në këtë seminar, sipas modelit të platformës së BE-së, për të marrë në konsideratë krijimin e një platforme rajonale për

<sup>2</sup> Faqja e internetit e Komisionit Evropian: Platforma e BE-së për bashkëjetesën midis njerëzve dhe mishngrënësve të mëdhenj: [http://ec.europa.eu/environment/nature/conservation/species/carnivores/coexistence\\_platform.htm](http://ec.europa.eu/environment/nature/conservation/species/carnivores/coexistence_platform.htm)

<sup>3</sup> Faqja e internetit e Komisionit Evropian: Platforma e BE-së për bashkëjetesën midis njerëzve dhe mishngrënësve të mëdhenj: nënfaqet e eventeve [http://ec.europa.eu/environment/nature/conservation/species/carnivores/events\\_sub\\_workshop\\_Budva.htm](http://ec.europa.eu/environment/nature/conservation/species/carnivores/events_sub_workshop_Budva.htm)

<sup>4</sup> Faqja e internetit e Komisionit Evropian: Deklarata e Budvës: [http://ec.europa.eu/environment/nature/conservation/species/carnivores/pdf/181106Budva\\_LCP\\_Workshop%20statement-EN.pdf](http://ec.europa.eu/environment/nature/conservation/species/carnivores/pdf/181106Budva_LCP_Workshop%20statement-EN.pdf)

mishngrënësit e mëdhenj, duke i çuar këto diskutime në një fazë tjetër.

## 1.1 Objektivi dhe masat e planifikuara

Krijimi i projektit kishte si objektiv kryesor ofrimin e kapacitetit njerëzor dhe financiar për krijimin e një platforme të shkëmbimit në nivel ndërkombëtar dhe vendosjen e parimeve udhëzuese për bashkëpunim në të ardhmen, së bashku me administratat kombëtare në rajon (Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Kroaci, Kosovë\*, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi dhe Slloveni).

Projekti merr masa për të asistuar në proceset e menaxhimit dhe shkëmbimit, për të:

- Përforcuar njohuritë lidhur me praktikatat dhe qëllimet e politikave të BE-së, në lidhje me menaxhimin e mishngrënësve të mëdhenj dhe transpozimin sa më të mirë të legjislacionit të BE-së për mjedisin;
- Përforcuar kapacitetin e autoriteteve menaxhuese lidhur me fillimin e proceseve të menaxhimit në nivel ndërkufitar dhe monitorimin e popullatës së mishngrënësve të mëdhenj;
- Përforcuar kapacitetin e grupeve të interesit nga sektorët përkatës që do të përfshihen në këto aktivitete, me synimin për të reduktuar konfliktet për praninë e mishngrënësve të mëdhenj.

Në këtë aspekt, ky mund të konsiderohet si një projekt nismëtar. Aktiviteti, i financuar nga Ministria Federale Gjermane e Mjedisit (BMU) përmes Programit Gjerman të Asistencës Këshillimore (Beratungshilfeprogramm)<sup>5</sup> është parashikuar të kryhet përgjatë një viti dhe për vazhdimësinë e tij në planin afatgjatë do të nevojiten fonde të mëtejshme. Projekti menaxhohet nga "adelphi", një institut kërkimor gjerman për politikatat mjedisore dhe konsulencë, në bashkëpunim me një OJQ kroate, "Carnivora Magna" - Instituti për studimin, ruajtjen dhe menaxhimin e mishngrënësve të mëdhenj. "Adelphi" administron edhe Sekretariatën e Platformës së BE-së për bashkëjetesën midis njerëzve dhe mishngrënësve të mëdhenj<sup>6</sup>. Anëtarët e "Carnivora Magna" janë ekspertë të menaxhimit të mishngrënësve të mëdhenj në rajon.

## 1.2 Qëllimi i këtij raporti

Ky raport ka si synim të japë informacion kontekstual, në mbështetje të krijimit të platformës. Në veçanti, ai ofron një përmbledhje të situatës aktuale, lidhur me menaxhimin e mishngrënësve të mëdhenj në rajon dhe krahasimin e qasjeve të vendeve të ndryshme. Kjo gjë lehtëson identifikimin e tematikave kryesore, të aktivitetit të platformës dhe potencialin për qasje të përbashkëta ndaj menaxhimit të mishngrënësve të mëdhenj në Alpet Dinarike.

<sup>5</sup> Faqja e internetit e UBA-s: Beratungshilfeprogramme: <https://www.umweltbundesamt.de/en/topics/sustainability-strategies-international/cooperation-eecca-centraleastern-european-states/federal-environment-ministrys-advisory-assistance>

<sup>6</sup> Faqja e internetit e Komisionit Evropian: Platforma e BE-së për bashkëjetesën midis njerëzve dhe mishngrënësve të mëdhenj: [http://ec.europa.eu/environment/nature/conservation/species/carnivores/coexistence\\_platform.htm](http://ec.europa.eu/environment/nature/conservation/species/carnivores/coexistence_platform.htm)



## 2 Prezantim me rajonin

### 2.1 Mishngrënësit e mëdhenj në Alpet Dinarike

Alpet Dinarike janë vargmale që shtrihen përgjatë Detit Adriatik dhe lidhen me Malet Pinde në juglindje të Ballkanit. Falë vendndodhjes së tyre në vijën ndarëse të disa rajoneve biogjeografike (Mesdhetare, Alpine dhe Kontinentale) dhe kushteve karakteristike ekologjike, klimatike dhe gjeomorfologjike, ato janë ndër rajonet me larminë më të madhe biologjike në Evropë.

Mishngrënësit e mëdhenj (në vijim referuar si MM) janë disa nga speciet karizmatike dhe karakteristike të zonës. Në rajon gjenden tri specie: ariu i murrmë (*Ursus arctos*), ujku gri (*Canis lupus*) dhe rrëqebulli i Euroazisë (*Lynx lynx*) duke përfshirë nënspéciet e tij të rralla (*Lynx lynx balcanicus*). Rajoni përfshin vendet e mëposhtme, që janë pjesë e këtij projekti: Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Kroaci, Kosovë\*, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi dhe Slloveni. Tek të gjitha këto vende ka popullatë të MM-ve, por asnjëra prej tyre nuk është mjaftueshëm e madhe sa për të krijuar popullatën e vet të mirëfilltë. Sipas vlerësimeve më të fundit në Listën e Kuqe rajonale të Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN) (2012-2016), ekzistojnë përafërsisht 4000 ujqër (popullata Dinarike-Balkanike), rreth 4000 arinj (popullata Dinarike-Pinde), 120-130 rrëqebuj (popullata e rrëqebullit në Alpet Dinarike) dhe vetëm 50 specie të rrëqebullit të Ballkanit (nënpopullata autoktone më e vogël dhe e kërcënuar e rrëqebullit të Euroazisë)<sup>7</sup>. Popullatat e MM-ve nuk kufizohen brenda kufijve të shteteve (shih fig. 1-3).




Figura 1: Shpërndarja e arinjve përgjatë Alpeve Dinarike (2012-16). Prania paraqitet në përmasat 10x10 km në shkallën evropiane LAEA-ETRS89 (Kaczensky et al. 2021)<sup>8</sup>.

<sup>7</sup> Faqja e internetit e Nismës Evropiane për Mishngrënësit e Mëdhenj (NEMM). Grupi i ekspertëve të specieve për IUCN-në: <https://www.lcie.org/Large-carnivores>

<sup>8</sup> Kaczensky, Petra et al. (2021), Distribution of large carnivores in Europe 2012 - 2016: Distribution maps for Brown bear, Eurasian Lynx, Grey wolf, and Wolverine, Dryad, Dataset, <https://doi.org/10.5061/dryad.pc866t1p3>




Figura 2: Shpërndarja e uikut përgjatë Alpeve Dinarike (2012-16)<sup>8</sup>.




Figura 3: Shpërndarja e rëqebullit përgjatë Alpeve Dinarike (2012-16)<sup>8</sup>. Ngjyra blu tregon praninë e përhershme, ndërsa ngjyra gurrkali praninë sporadike.

Krahas tetë shteteve të mësipërme, popullata e lartpërmendur e ujkut shtrihet edhe në Greqi dhe Bullgari, ndërsa popullata e ariut shtrihet dhe në Greqi. Edhe pse nuk janë partnerë zyrtarë në projekt, Greqia dhe Bullgaria do të ftohen që të marrin pjesë në takime dhe do të përfshihen në proceset e platformës, sipas mundësisë.

Ashtu si në Evropën Perëndimore, në pjesën më të madhe të Alpeve Dinarike, popullatat e MM-ve kanë qenë objekt i drejtpërdrejtë i gjuetisë deri në mesin e shekullit të njëzetë. Megjithatë, në rastin e Alpeve Dinarike, popullatat e arinjve dhe ujqërve nuk u zhdukën. Popullata e arinjve arriti nivelet më të ulëta pas luftës së dytë botërore dhe vuajti pasoja të mëtejshme në disa vende gjatë konfliktit që çoi në shpërbërjen e Jugosllavisë, në fillim të viteve 1990-të.

Megjithatë, popullatat e tyre janë rikuperuar vitet e fundit. Në shumë vende, ujqërit ishin objekt i gjuetisë me shpërblim dhe konsideroheshin si specie dëmtuese. Vetëm së fundmi, ata kanë përfitur mbrojtje në një pjesë të rajonit. Mbijetesa e tyre vjen kryesisht si rezultat i përshtatshmërisë, potencialit riprodhues dhe habitateve të mjaftueshme për pre në pjesën më të madhe të rajonit.

Rrëqebulli dinarik u zhduk gjatë viteve të para të shekullit të 20-të. Një popullatë e vogël e mbetur, që sot është një nënspecie e veçantë e njohur si rrëqebulli i Ballkanit mbijetoi, por ende konsiderohet në rrezik kritik. Popullata dhe lloji i tyre është reduktuar ndjeshëm, ndërkohë që po bëhen përpjekje intensive për ruajtjen e kësaj popullate të izoluar. Kjo popullatë, e zhdukur plotësisht në perëndim të rajonit, filloi të rikuperohej përmes transferimit të specieve nga popullata e tyre në Sllovakia, përmes programit të rikuperimit, që nisi në vitin 1973. Pas shtimit fillestar, popullata u ul dhe mbeti e tillë deri në vitet e fundit, kur nisën përpjekjet shpesh për zgjerimin e diversitetit gjenetik të popullatës së tyre të vogël.

## **2.2 Kuadri institucional dhe faktori i anëtarësimit në BE**

Shtetet e përfshira nuk kanë një kuadër ligjor gjithëpërfshirës, në bazë të të cilit të organizojnë menaxhimin e natyrës në nivel ndërkufitar. Disa nga shtetet janë të anëtarësuara në BE dhe disa të tjera jo. Nuk ka një konventë Dinariko-Ballkanike, siç është Konventa e Alpeve apo ajo e Karpateve. Nismat ndërkufitare në shkallë të gjerë, mbeten ende sfiduese pas luftërave Jugosllave në vitet 1990-të. Edhe brenda shteteve individuale, në veçanti në Bosnjë-Hercegovinë, qasjet ndaj menaxhimit të MM-ve mund të ndryshojnë sipas rajoneve të ndryshme.

Të gjitha shtetet e përfshira ose janë ndërkohë shtete anëtare të BE-së, ose vende në negociatë për anëtarësim ose kandidate të mundshme. Rrjedhimisht, perspektiva e anëtarësimit në BE, ofron një kuadër të përbashkët të rëndësishëm për zonën.

Për t'u anëtarësuar, shtetet duhet të dëshmojnë se respektojnë Kriteret e Kopenhagës për institucione të qëndrueshme, të drejtat e njeriut dhe ligjin<sup>9</sup>. Në rastin e vendeve të Ballkanit Perëndimor, "Proçesi i Stabilizim-Asociimit" përcakton kushte shpesh për anëtarësimin, që lidhen kryesisht me bashkëpunimin rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë. Prandaj, bashkëpunimi ndërkufitar është shumë i rëndësishëm.

Marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet shteteve kandidate dhe BE-së bëhen në formën e marrëveshjeve të stabilizim-asociimit (MSA-ve). Statusi aktual i diskutimeve përmbledhet në

---

<sup>9</sup> Këshilli Evropian (1993), Kriteret e Kopenhagës: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/enlargement-policy/conditions-membership\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/enlargement-policy/conditions-membership_en)

tabelën 1.

Tabela 1: Statusi i anëtarësimit në BE.

Shteti	Statusi i anëtarësimit në BE	Informacione të mëtejshme
Shqipëria	Vend kandidat (negociatat nuk kanë nisur ende)	Ka bërë kërkesën për anëtarësim në prill të vitit 2009 Ka marrë statusin e vendit kandidat në qershor të vitit 2014 Komisioni rekomandoi hapjen e negociatave në vitin 2016 - Këshilli rra dakord në mars të vitit 2020 Kudri i Komisionit në qershor të vitit 2020
Bosnjë- Hercegovina	Vend kandidat i mundshëm	Ka bërë kërkesën për anëtarësim në shkurt të vitit 2016 Opinionet e Komisionit me 14 prioritetet në maj të vitit 2019 Një nga prioritetet është funksionimi i duhur i Komisionit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit (KPSA), dimensionit parlamentar të MSA-së - miratuar nga parlamenti i Bosnjë- Hercegovinës në qershor të vitit 2021
Kroacia	Shtet anëtar i BE-së	Është anëtarësuar në BE më 1 korrik 2013
Kosova*	Vend kandidat i mundshëm	Deklaroi pavarësinë nga Serbia në mënyrë të njëanshme në shkurt të vitit 2008 Pesë shtete anëtare të BE-së (Qipro, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja) dhe dy vende të rajonit (Serbia dhe Bosnjë- Hercegovina) nuk e kanë njohur ende pavarësinë e Kosovës*. MSA-ja hyri në fuqi më 1 prill 2016 Anëtarësimi lidhet me suksesin apo dialogun e nivelit të lartë të ndërmjetësuar nga BE-ja midis Kosovës* dhe Serbisë
Mali i Zi	Vend kandidat (në negociatave e sipër, mund të anëtarësohet në vitin 2025)	Ka bërë kërkesën për anëtarësim në dhjetor të vitit 2008 Ka marrë statusin e vendit kandidat në dhjetor të vitit 2010 Negociatat e anëtarësimit janë hapur në qershor të vitit 2012 Janë hapur të 33 kapitujt e përzgjedhur të negociatave, vetëm 3 janë mbyllur përkohësisht
Maqedonia e Veriut	Vend kandidat (negociatat nuk kanë nisur ende)	Ka bërë kërkesën për anëtarësim në mars të vitit 2004 Ka marrë statusin kandidat në dhjetor të vitit 2005 Negociatat e anëtarësimit janë penguar për shkak të mosmarrëveshjeve me Greqinë lidhur me emrin "Maqedoni". Mosmarrëveshja u zgjidh përmes "Marrëveshjes së Prespës", që ka hyrë në fuqi në shkurt të vitit 2019 Këshilli vendosi të hapë negociatat e anëtarësimit në Mars të vitit 2020 Komisioni paraqiti draft-kudrin për hapjen e negociatave në Qershor të vitit 2020
Serbia	Vend kandidat (në negociatave e sipër, mund të anëtarësohet në vitin 2025)	Ka bërë kërkesën për anëtarësim në dhjetor të vitit 2009 Ka marrë statusin kandidat në mars të vitit 2012 Negociatat e anëtarësimit u hapën zyrtarisht në janar të vitit 2014 Dy kapitujt e parë, duke përfshirë kapitullin për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën* u hapën në dhjetor të vitit 2015 Deri më sot, janë hapur 18 nga 35 kapitujt të negociatave, dy prej të cilëve janë mbyllur përkohësisht Anëtarësimi lidhet me suksesin apo dialogun e nivelit të lartë të ndërmjetësuar nga BE-ja midis Kosovës* dhe Serbisë
Sllovenia	Shtet anëtar i BE-së	Është bërë pjesë e BE-së më 1 maj 2004

Në kudër të procesit të anëtarësimit, vendet duhet të provojnë aftësinë e tyre për respektimin e legjislacionit të BE-së (d.m.th. *acquis communautaire*) duke transpozuar direktivat dhe rregulloret përkatëse në legjislacionin e brendshëm. Negociatat e anëtarësimit kanë në fokus

rreth 35 kapituj<sup>10</sup> që mbulojnë tërësinë e legjislacionit të BE-së. Kapitulli 27 mbulon mjedisin, duke përfshirë mbrojtjen e specieve sipas Direktivës "Për habitatet" dhe krijimin e rrjetit Natura 2000 për zonat e mbrojtura.

BE-ja ofron asistencë financiare për krijimin e këtij kuadri. Prandaj, kuadrot e BE-së mbeten tejtejt të vlefshme, pavarësisht fazës së anëtarësimit, teksa njohja dhe zbatimi i legjislacionit për mjedisin është një sfidë e përbashkët që përjetohet nga të gjitha vendet.

## **Kutia 2: Direktiva e BE-së "Për habitatet"**

Direktiva "Për habitatet" e vitit 1992 (e Këshillit Evropian, viti 1992), zbaton Konventën e Bernës (shih kutinë 3) në Bashkimin Evropian (BE), ku parashikohet shtimi i mekanizmave më të fortë të zbatimit dhe raportimit.

Një koncept kyç i Direktivës është se të gjitha speciet dhe habitatet e renditura duhet të mbahen ose ruhen me statusin e favorshëm të ruajtjes (SFR). Llojet e masave të nevojshme dhe/ose të lejuara për marrjen e SFR-së ndryshojnë në varësi të specieve ose habitateve. Në shtojcën II renditen speciet që kanë nevojë për përcaktimin e zonave të veçanta të ruajtjes (ZVR-të) për marrjen e SFR-së, në shtojcën IV renditen speciet e mbrojtura në mënyrë strikte (kapja, vrasja ose shqetësimi i këtyre specieve apo i zonave të strehimit/habitatit të tyre është e ndaluar) ndërsa në shtojcën V renditen specie që mund të shfrytëzohen, vetëm nëse kjo gjë përputhet me mbajtjen e tyre në SFR.

Ariu, ujku dhe rrëqebulli janë specie të mbrojtura sipas shtojcës II në pjesën më të madhe të vendeve të BE-së, duke përfshirë Kroacinë dhe Slloveninë (ku ariu dhe ujku konsiderohen specie me prioritet). Ariu është specie e mbrojtur sipas shtojcës IV në të gjitha vendet e BE-së, ndërsa ujku dhe rrëqebulli në pjesën më të madhe të vendeve të BE-së, duke përfshirë Slloveninë dhe Kroacinë.

Mbrojtja strikte sipas shtojcës IV nuk e përjashton plotësisht eliminimin e specieve nga popullata. Derogimet sipas nenit 16, lejojnë menaxhimin e eliminimit sipas rrethanave të veçanta (për shembull për mbrojtjen e pjesës tjetër të faunës dhe florës ose për parandalimin e dëmeve të rënda, p.sh., ndaj kulturave ose bagëtive apo për qëllime të sigurisë publike). Sllovenia dhe Kroacia përdorin derogime për menaxhimin e ariut dhe të ujkut.

Dokumenti i parë udhëzues për mbrojtjen strikte të specieve shtazore me interes për Komunitetin Evropian sipas Direktivës "Për habitatet", u botua në vitin 2007. Ai kishte si synim që të mundësonte kuptueshmëri më të lartë të dispozitave për mbrojtjen e specieve dhe të termave specifikë të përdorur. Në tetor të vitit 2021, u publikua një dokument udhëzues, i rishikuar, për mbrojtjen strikte të specieve shtazore me interes për Komunitetin Evropian, sipas Direktivës "Për habitatet"<sup>11</sup>. Dokumenti fokusohet në detyrimet që lindin nga nenet 12 dhe 16 të Direktivës "Për habitatet". Këto detyrime përcaktojnë një sistem të mbrojtjes strikte të specieve shtazore të renditura në shtojcën IV (a) të Direktivës, teksa mundësojnë derogime nga këto dispozita sipas disa kushteve të caktuara. Dokumenti në fjalë bazohet kryesisht në vendimet përkatëse të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GjKBE) dhe në shembuj të sistemeve të mbrojtjes së specieve në shtete të ndryshme anëtare. Në shtojcën III

<sup>10</sup> Faqja e internetit e Komisionit Evropian: Politika e fqinjësisë dhe zgjerimit: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/enlargement-policy/conditions-membership/chapters-acquis\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/enlargement-policy/conditions-membership/chapters-acquis_en)

<sup>11</sup> Faqja e internetit e Komisionit Evropian: Dokumenti udhëzues për Direktivën "Për habitatet" [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=PI\\_COM:C\(2021\)7301](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=PI_COM:C(2021)7301)

jepet një shembull se si mund të zbatohet dokumenti udhëzues në rastin e ujkut.

### Konventat ndërkombëtare

Të gjitha vendet e tjera janë nënshkruese të dy konventave ndërkombëtare, të cilat parashtrojnë disa rregulla lidhur me mbrojtjen e MM-ve, pra Konventa e Bernës dhe CITES (Konventa për tregtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër). Më shumë informacione për kuadrin ligjor ndërkombëtar gjenden në kutinë 3.

#### Kutia 3: Konventa e Bernës dhe CITES

Konventa "Për ruajtjen e faunës dhe florës së egër dhe habitateve natyrore të Evropës" së vitit 1979 (**Konventa e Bernës**<sup>12</sup> është një instrument ndërkombëtar ligjor detyrues, që mbulon kontinentin Evropian dhe disa pjesë të Afrikës, ku renditen habitatet dhe speciet që duhet të mbrohen nga vendet nënshkruese të konventës. Speciet e përfshira në shtojcën II janë të mbrojtura në mënyrë strikte (kapja, vrasja ose shqetësimi i këtyre specieve apo i zonave të strehimit/habitatit të tyre është e ndaluar). Speciet e përfshira në shtojcën III janë të mbrojtura (ato mund të jenë objekt gjuetie, por kjo gjë duhet të rregullohet në mënyrë që popullatat mos të kthehen në specie të rrezikuara, p.sh. përmes masave të tilla si, sezonet e ndaluara të gjuetisë dhe ndalimet e përkohshme ose vendore për të mundësuar rikuperimin e popullatës). Ariu dhe ujku janë specie të mbrojtura në mënyrë strikte sipas shtojcës II të Konventës së Bernës. Rrëqebulli përfshihet në shtojcën III, megjithatë nën speciet që përfshijnë rrëqebullin e Ballkanit, janë pjesë e shtojcës II. Vendet nënshkruese mund të shprehin rezervat e tyre duke mos konsideruar disa specie të caktuara si të mbrojtura, sipas konventës. Maqedonia e Veriut ka shprehur një rezervë për ujkun në shtojcën II. Sllovenia ka shprehur rezerva për ariun dhe ujkun edhe pse duke qenë se ato përfshihen në shtojcën IV të Direktivës "Për habitatet", kjo gjë ka pak vlerë në praktikë. Kosova\* nuk është vend nënshkrues i Konventës.

**CITES**<sup>13</sup> (Konventa për tregtinë ndërkombëtare, të specieve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër) ka hyrë në fuqi në vitin 1975. Konventa rregullon shfrytëzimin dhe tregtimin e specieve të rrezikuara në rang botëror. Për MM-të, CITES ka vlerë të veçantë për trofetë e gjuetisë, pasi kontrollon lejet, për heqjen e kafshëve të gjuajtura nga vendi ku janë vrarë. CITES i përfshin listat e specieve në tri shtojca në varësi të lejimit ose jo të tregtisë (shtojca 1), kur tregtia kontrollohet në mënyrë strikte përmes lejeve (shtojca 2) ose kur tregtia kontrollohet përmes lejeve por sipas një sërë rrethanash të ndryshme (shtojca 3). Ujku, ariu dhe rrëqebulli përfshihen në shtojcën 2 për vendet evropiane.

Vendet nënshkruese mund të shprehin rezervat e tyre lidhje me statusin e mbrojtjes së disa specieve, sipas konventës. Maqedonia e Veriut ka shprehur rezervat e saj për ujkun që në vitin 2000. Kosova\* nuk është vend nënshkrues i Konventës.

Qasjet e ndryshme të praktikuara në vende të ndryshme për zbatimin e direktivave dhe traktateve të lartpërmendura, kanë rezultuar në një larmi qasjesh, ndaj menaxhimit të MM-ve

<sup>12</sup> Këshilli i Evropës (1979), Traktati Nr. 104 - Konventa e Bernës - Konventa "Për ruajtjen e faunës dhe florës së egër dhe habitateve natyrore të Evropës": <https://www.coe.int/en/web/bern-convention>

<sup>13</sup> CITES (1973) Konventa për tregtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër: <https://cites.org/eng>



në mbarë Alpet Dinarike, siç është përshkruar më tej gjatë rezultateve dhe diskutimeve.

### 2.3 Mësimet nga përvojat e BE-së rreth bashkëjetesës me mishngrënësit e mëdhenj

MM-të janë specie me natyrë potencialisht konfliktuale në të gjithë gamën e tyre. Si specie karizmatike, ato mund të sjellin përfitime të tilla si tërheqja e turistëve (duke përfshirë gjahtarët në disa vende), gjithashtu kanë rol në menaxhimin e ekosistemit (shërbime ekologjike, si dhe shërbime socio-ekonomike dhe kulturore)<sup>14</sup>. Megjithatë, prania e tyre lidhet me kostot që rëndojnë mbi sektorët e vegjël, shumë specifike të shoqërisë. Nevojat biologjike të MM-ve nënkuptojnë se ato kanë gjasa të konfliktohen me popullsinë rurale, në veçanti me mbarështuesit e bagëtive, rritësit e bletëve, fermerët dhe me gjasa edhe gjahtarët. Shoqëria ka bërë një zgjedhje, duke mbrojtur MM-të për të nxitur ruajtjen e tyre, si dhe rikthimin në zona të caktuara ku janë zhdukur.

Prandaj, lind dhe përgjegjësia për **menaxhimin dhe koordinimin** e ruajtjes së MM-ve, së bashku me grupet e prekura të interesit, zakonisht përmes një **plani menaxhimi të koordinuar**, të zhvilluar në bashkëpunim me grupet e interesit. Kjo gjë mund të bëhet vetëm kur të arrihet **monitorimi** i saktë dhe i besueshëm i **popullatave të MM-ve dhe i ndikimeve të tyre**, si p.sh. sulmimi ndaj bagëtisë.

**Kompensimi për dëmet** e shkaktuara nga MM-të dhe **mbështetja financiare për masat e mbrojtjes** konsiderohen si disa nga hapat e para për reduktimin e konfliktit. Pjesa më e madhe e vendeve të BE-së po shkojnë gradualisht drejt një sistemi ku paguhet për kompensimin e dëmeve ndaj bagëtive, koshereve të bletëve ose ndaj bujqësisë, përmes fondeve shtetërore dhe për marrjen e masave parandaluese (rrethimet, qentë e stanit, barinjte, shih Figura 4) përmes fondeve shtetërore ose Fondit Evropian Bujqësor për Zhvillim Rural, FEBZhR (shtylla e zhvillimit bujqësor të Politikës së Përbashkët Bujqësore, PPB)<sup>15</sup>. Kjo gjë ka gjasa të vazhdojë, sipas PPB-së së re (nga viti 2023) me shtimin e fondeve të mundshme përmes skemave ekologjike (pagesave direkte)<sup>16</sup>. Është e dukshme që kompensimi dhe masat parandaluese janë të favorshme për të qenë të paanshëm me fermerët, por sidoqoftë, këto skema duhet të planifikohen dhe prezantohen me kujdes, për të shmangur përshkallëzimin e konflikteve<sup>17</sup>.

---

<sup>14</sup> Tišma, S., Jelinčić, D.A., Tolić, I., Solić, A. i Malić Limari, S. (2021). Tko se boji vuka još? Socio-ekonomski i kulturološki učinci obitavanja vuka u Hrvatskoj. *Socijalna ekologija*, 30 (1), 117-130. <https://doi.org/10.17234/SocEkol.30.1.6> (Socijalna ekologija: journal for environmental thought and sociological research = Socijalna ekologija: Zeitschrift für Umweltgedanken und soziologische Forschung, Vol. 30 No. 1, 2021

<sup>15</sup> Marsden, K and T. Hovardas EU Rural Development Policy and the management of conflictual species: The case of large carnivores in: *Biological Conservation* 243: DOI: 10.1016/j.biocon.2020.108464

<sup>16</sup> Shënimi informues për platformën e BE-së lidhur me MM-të: Reformimi i Politikës Bujqësore të Përbashkët (CAP) dhe masat për bashkëekzistencën me mishngrënësit e mëdhenj: [https://ec.europa.eu/environment/nature/conservation/species/carnivores/pdf/EU\\_Platform\\_CAP\\_and\\_large\\_carnivores\\_July21.pdf](https://ec.europa.eu/environment/nature/conservation/species/carnivores/pdf/EU_Platform_CAP_and_large_carnivores_July21.pdf)

<sup>17</sup> Boitani, L., Ciucci, P., and Raganella-Pelliccioni, E. (2010). Ex-post compensation payments for wolf predation on livestock in Italy: a tool for conservation? *Wildlife Research* 37: 722-730. [https://www.kora.ch/malme/05\\_library/5\\_1\\_publications/B/Boitani\\_et\\_al\\_2010\\_Compensation\\_payments\\_for\\_wolf\\_predation\\_on\\_livestock\\_in\\_Italy.pdf](https://www.kora.ch/malme/05_library/5_1_publications/B/Boitani_et_al_2010_Compensation_payments_for_wolf_predation_on_livestock_in_Italy.pdf)



Figura 4: Masat për mbrojtjen e bagëtive (rrethimi dhe qeni i stanit; Autorja e fotos: Irena Kavčič).



Duke marrë në konsideratë krahasimet në nivel BE-je, shihet qartazi që kompensimet më të larta dhe pagesat për parandalimin nuk rezultojnë domosdoshmërisht në nivelin më të ulët të konfliktit, ndërkohë që duhen marrë në konsideratë dhe faktorë të tjerë<sup>18</sup>.

Konfliktet shkaktohen edhe nga **ndërveprimet e drejtpërdrejta ndërmjet njerëzve dhe MM-ve**, veçanërisht me arinjte, pra në rastet kur njerëzit kanë kontakt të drejtpërdrejtë me ta dhe rrezikojnë të lëndohen apo të vriten nga arinjte. Kjo gjë mund të trajtohet kryesisht duke i bërë njerëzit më të ndërgjegjshëm për mënyrën se si sillen në habitatin e arinjve, duke reduktuar kontaktin përmes **menaxhimit të mbetjeve** (duke reduktuar qasjen e arinjve në mbeturina); **menaxhimit të qarkullimit** (urëkalimet ekologjike, rrethimet dhe sinjalistika për reduktimin e aksidenteve); përmes përpjekjeve për të rregulluar inkursionet në habitatet e arinjve (aksesi për qëllime sporti dhe gjuetie dhe duke monitoruar ndikimet e ushqimeve suplementare për qëllime gjuetie apo të vëzhgimit të arinjve); dhe përmes përmirësimit të konektivitetit të **habitatit** të arinjve (planifikimi i infrastrukturës).

Krahas kësaj, mjetet për regjistrimin dhe përballimin e incidenteve janë të rëndësishme. Disa vende kanë vendosur në gatishmëri **ekipe emergjencash** ose të ndërhyrjes (EN-të) për MM-të për të tria speciet, ose për secilën specie në veçanti, për të përballuar incidentet ose për të zhvendosur potencialisht arinjte që zhvillojnë sjellje agresive (shih Figura 5). Është e rëndësishme që këto ekipe, të mbajnë shënim se cili aspekt i sjelljes së njerëzve ose arinjve/ujqërve/rrëqebujve mund të ketë shkaktuar konflikte, duke asistuar kështu në ndryshimin e praktikave dhe shmangien e incidenteve në të ardhmen.



Figura 5. Ekipe të ndërhyrjes për arinjte, të vendosura në disa vende të BE-së, duke përfshirë Kroacinë (Autori i fotos: Djuro Huber).

<sup>18</sup> Marsden, K. (2018) Preventing damage by large carnivores: A comparative overview of the use of the European Agricultural Fund for Rural Development to protect livestock in the Alpine countries: [https://www.adelphi.de/en/system/files/mediathek/bilder/26022019\\_WISO-EAFRD-report-adelphi\\_FINAL.pdf](https://www.adelphi.de/en/system/files/mediathek/bilder/26022019_WISO-EAFRD-report-adelphi_FINAL.pdf)

**Menaxhimi i eliminimit** praktikohet në disa vende evropiane. Në shumë shtete, speciet problematike (arinjtë ose ujqërit) që kanë shmangur me sukses masat parandaluese, mund të eliminohen nga popullata përmes derogimeve. Ndonjëherë, derogimet përdoren edhe për kontrollin e gjerë të popullatës, p.sh. eliminime si masë parandaluese, të disa individëve nga popullata. Në disa shtete të BE-së<sup>19</sup>, gjuetia lejohet aty ku ujqërit bëjnë pjesë në shtojcën V të Direktivës "Për habitatet".

Konfliktet lidhur me MM-të lidhen me interesat ekonomikë por mund të jenë edhe më të thella. Ato mund të pasqyrojnë **pikëpamje të ndryshme socio-kulturore** të së ardhmes së zonave rurale, ku konfliktet midis grupeve të ndryshme të njerëzve mund të projektohen te MM-të<sup>20</sup>. Për mbështetjen e bashkëjetesës mund të vijjnë në ndihmë një sërë mjetesh, siç vihet re nga rastet studimore të platformës së BE-së<sup>21</sup> dhe në udhëzimin e fundit të Komisionit Evropian për speciet<sup>22</sup>. Përfshirja e grupeve të interesit në diskutimet rreth menaxhimit të MM-ve, p.sh. përmes **ngritjes së platformave të grupeve të interesit**, shihet si një hap i rëndësishëm për të shmangur thellimin e konflikteve.

Krahas sjelljes së përvojave të BE-së në Alpet Dinarike, ky projekt do të synojë edhe transferimin e përvojave të Alpeve Dinarike në vendet e BE-së. Shumë shtete të Evropës Perëndimore ose Qendrore, si p.sh. Gjermania, i kanë humbur popullatat e MM-ve, dhe për këtë arsye konfliktet, gjatë rikthimit të tyre, mbeten veçanërisht të mëdha. Përvoja e Alpeve Dinarike e bashkëjetesës së vazhdueshme mund të na ofrojë mësim të vyer.

---

<sup>19</sup> Arinjtë e Alpeve Dinarike-Maleve të Pindit janë objekt gjuetie ose pjesë e listës së kafshëve të gjuetisë në Slloveni, Kroaci, Bosnjë-Hercegovinë dhe Mal të Zi, por jo në Serbi, Maqedoni të Veriut, Shqipëri ose Greqi sipas Huber et al (2021) The status of hunting of brown bears in Europe: is it good or bad for bears? Prezantim verbal i pabotuar në seancën e Grupit të ekspertëve të arinjve

<sup>20</sup> p.sh. Linnell, J. (2013) From conflict to coexistence? Insights from multidisciplinary research into the relationships between people, large carnivores and institutions: [https://ec.europa.eu/environment/nature/conservation/species/carnivores/pdf/task\\_4\\_conflict\\_coexistence.pdf](https://ec.europa.eu/environment/nature/conservation/species/carnivores/pdf/task_4_conflict_coexistence.pdf)

<sup>21</sup> Faqja e internetit e Komisionit Evropian: rastet studimore për bashkëjetesën: [https://ec.europa.eu/environment/nature/conservation/species/carnivores/case\\_studies.htm](https://ec.europa.eu/environment/nature/conservation/species/carnivores/case_studies.htm)

<sup>22</sup> Komisioni Evropian (2021) Dokument udhëzues për mbrojtjen strikte të specieve shtazore me interes për Komunitetin Evropian sipas Direktivës "Për habitatet": [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=PI\\_COM:C\(2021\)7301&from=EN](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=PI_COM:C(2021)7301&from=EN)

### 3 Metoda e mbledhjes së informacionit

Për të kuptuar më mirë panoramën e situatës ekzistuese, ekipi i projektit përgatiti një model intervistimi për të mbledhur informacione lidhur me rregullimin dhe menaxhimin e MM-ve në Alpet Dinarike. Modeli u bazua në rishikimin e literaturës ekzistuese dhe përshtypjet e ekspertëve, veçanërisht nga Bordi Këshillimor i projektit. Modeli i intervistës (shtojca 1) u përdor për të kryer 42 intervista me ekspertë të qeverisë, shoqërisë civile dhe akademikë nga vendet e përfshira (shih shtojcën 2 për listën e të intervistuarve). Të intervistuarit u identifikuan përmes kontakteve të sekretariatit të platformës në rajon, partnerëve të projekteve dhe përshtypjeve nga bordi këshillimor, si dhe nga vetë të intervistuarit.

Intervistat u strukturuan rreth një sërë tematikash të renditura më poshtë, të cilat kontribuojnë në suksesin ose bashkëpunimin për menaxhimin e MM-ve:

Tematikat e vlerësuara për secilin vend ishin:

- Historiku i vendit (zona, popullata dhe përdorimi i tokës, struktura institucionale)
- Autoritetet menaxhuese të lidhura me menaxhimin e MM-ve
- Zbatimi i së drejtës ndërkombëtare të BE-së
- Legjislacioni kombëtar dhe rajonal
- Statusi, tendencat dhe shpërndarja e MM-ve
- Planet e menaxhimit të MM-ve dhe metodat e monitorimit
- Kërcënimet kryesore ndaj popullatës
  - Konfliktet kryesore të lidhura me praninë e MM-ve
  - Masat e mbrojtjes dhe kompensimit të bagëtive
  - Statusi i gjuetisë
  - Nismat ekzistuese ndërkufitare

Kryesisht, intervistat u zhvilluan me lidhje video ose me telefon. Të intervistuarit u informuan mbi mënyrën se si do të përdoren të dhënat dhe se përgjigjet e tyre do të mbeteshin anonime në nivel individual, edhe pse lista e të intervistuarve do të publikohet. Intervista u zhvillua me pyetje-përgjigje, në shumicën e rasteve të gjuhën amtare të të intervistuarve dhe në disa raste në gjuhën angleze. Përgjigjet e tyre u përkthyen në gjuhën angleze dhe u vunë në dispozicion të ekipit për analizim. Përgjigjet u përdorën për të bërë përmbledhje të pikëpamjeve për secilin nga vendet që renditet më poshtë (fishat e vendeve) si dhe tabela krahasuese dhe përshkrimet gjatë diskutimit.

Intervistat kishin qëllimin e dyfishtë të mbledhjes së informacionit dhe qëmtimit të interesit për pjesëmarrjen në takimet e platformës. Prandaj, ishte shumë e rëndësishme që të arrihej gama e plotë e të intervistuarve në secilin vend, në masën më të madhe të mundshme. Për këtë arsye, gjatë përzgjedhjes së të intervistuarve, ekipi synonte të arrinte një ekuilibër midis aktorëve shtetërorë, interesave të ruajtjes, akademikëve, aktorëve të gjuetisë dhe bujqësisë.

Qartazi, të intervistuarit kishin mendimet e tyre lidhur me menaxhimin e MM-ve. Rrjedhimisht, analizat u shqyrtuan me kujdes për të bërë dallimin midis opinionëve, qëndrimeve zyrtare dhe provave shkencore. Më poshtë përfshihen kualifikuesit e përshtatshmërisë, ku faktet kundërshtohen ose janë të pasigurta.

## 4 Rezultatet

Rezultatet bazohen në dy rishikime të mëparshme të menaxhimit në rajon, të kryera në intervale rreth 10-vjeçare. Vlerësimi fillestar i qasjeve të menaxhimit u krye sipas Konventës së Bernës në vitin 2002<sup>23</sup>. Nisma Evropiane për Mishngrënësit e Mëdhenj (NEMM) ka kryer gjithashtu anketa në mbarë Evropën duke përdorur pyetësorët e ekspertëve (të përmbledhur nga Kaczensky et al. 2012)<sup>24</sup>. Informacioni jepet në fashat e vendeve dhe përshkrimet e mëposhtme (shih shtojcën 3). Shtojca 4 ofron një krahasim të evoluimit të këtyre përmbledhjeve. Mund të shihet se edhe pse ka pasur zhvillime drejt mbrojtjes strikte të specieve të MM-ve me kalimin e kohës, **pjesa më e madhe e problemeve të identifikuara në vitin 2002 dhe sërish në vitin 2012, vazhdojnë edhe në vitin 2021**.

Ato përshkruhen më poshtë në mënyrë të përmbledhur dhe mund të shqyrtohen në detaj për vendet individuale në fashat e vendeve (shtojca 3).

### 4.1 Statusi i popullatës

Tabela 2 jepet një përmbledhje e popullatave të përlogaritura në secilin vend në bazë të përgjigjeve të intervistës (shifra zyrtare apo gjykimi i ekspertëve). Siç përshkruhet më poshtë, vetëm disa vende disponojnë sisteme të sakta monitorimi dhe pjesa më e madhe e shifrave janë përlogaritje të paverifikuara. Megjithatë, përmbledhja e shifrave rezulton në numra të ngjashëm me përlogaritjet e NEMM-së, siç u përmend më sipër në këtë raport (përafërsisht 4000 ujçër (popullatë Dinarike-Ballkanike), rreth 4000 arinj (popullatë Dinarike-Pinde), 120-130 rrëqebuj (popullata e rrëqebullit në Alpet Dinarike) dhe vetëm 50 specie të rrëqebullit të Ballkanit (Kaczensky et al. 2021<sup>8</sup>). Sigurisht që, popullatat ndryshojnë ndërmjet vendeve në varësi të madhësisë, peizazhit dhe zgjedhjeve për menaxhimin e tyre. Nuk përjashtohet as numërimi i dyfishtë midis shteteve.

Tabela 2: Statusi dhe tendenca e popullatës

Shifrat për vitin 2021 (\* = përlogaritje të paverifikuara, për rrëqebullin () = nënpopullata e rrëqebullit të Ballkanit, "-" = nuk ka të dhëna).

Shteti	Ariu Përlogaritjet	Ariu Tendencat	Ujku Përlogaritjet	Ujku Tendencat	Rrëqebullit Përlogaritjet	Rrëqebullit Tendencat
Shqipëria	*180-200	E qëndrueshme në nivel kombëtar	*200-250	E qëndrueshme	(5-10)	E qëndrueshme me tendencë në ulje
Bosnjë-Hercegovina	*1000-1200	Në rritje të lehtë	400-600	E qëndrueshme ose në zbritje	*80-90	-
Kroacia	846-1072	E qëndrueshme	163	Në zbritje ose e qëndrueshme	85-90	E qëndrueshme ose lehtë
Kosova*	*80-100	-	*100	-	*(6)	-

<sup>23</sup> Konventa për Ruajtjen e Jetësë Egër në Evropë dhe Habitatet Natyrore - Takimi i 22-të i Komitetit të Përhershëm (2002) Planet e veprimit për mishngrënësit e mëdhenj në Malet Dinarike - Malet e Pindit <https://cupdf.com/document/ap-dinara-pindus-range-lc-large-carnivore-action-plans-f-or-dinara-pindus.html>

<sup>24</sup> Petra Kaczensky, Guillaume Chapron, Manuela von Arx, Djuro Huber, Henrik Andrén, and John Linnell (Editors) (2012) Status, management and distribution of large carnivores – bear, lynx, wolf & wolverine – in Europe part 1: [https://ec.europa.eu/environment/nature/conservation/species/carnivores/pdf/task\\_1\\_part1\\_statusofcineurope.pdf](https://ec.europa.eu/environment/nature/conservation/species/carnivores/pdf/task_1_part1_statusofcineurope.pdf) and part 2: [https://ec.europa.eu/environment/nature/conservation/species/carnivores/pdf/task\\_1\\_part2\\_species\\_country\\_reports.pdf](https://ec.europa.eu/environment/nature/conservation/species/carnivores/pdf/task_1_part2_species_country_reports.pdf)

Shteti	Ariu Përlllogaritjet	Ariu Tendencat	Ujku Përlllogaritjet	Ujku Tendencat	Rrëqebullit Përlllogaritjet	Rrëqebullit Tendencat
Mali i Zi	*423	-	*592	-	*(0)	-
Maqedonia e Veriut	*333-381	E qëndrueshme ose lehtë	*400-1100	Në zbritje të lehtë-	(32)	E qëndrueshme-
Serbia	*100	Në rritje	*800-900	E qëndrueshme ose në rritje të lehtë	*40-60	E qëndrueshme
Slovenia	700-900	Në rritje	104-129	Në rritje	29	-

Popullatat më të mëdha të arinjve gjenden në Bosnjë-Hercegovinë, Kroaci dhe Sloveni, ndërsa në vendet e tjera popullatat janë relativisht të vogla. Nga ana tjetër, Serbia dhe Maqedonia përlllogariten që të kenë popullatat më të larta të ujqërve. Ndërkohë që popullatat e rrëqebullit janë të ulëta në të gjithë rajonin.

## 4.2 Legjislacioni dhe statusi i gjuetisë

Intervistat dhe krahasimet me përmbledhjet e mëparshme tregojnë se ka pasur një evoluim gradual drejt mbrojtjes së specieve të MM-ve për të përmbushur kërkesat e Konventës së Bernës (ose Direktivën "Për habitatet" në rastin e Slovenisë dhe të Kroacisë). Në Maqedoninë e Veriut, ujku është pjesë e listës së kafshëve të gjuetisë dhe kjo e fundit nxitet akoma më shumë me shpërblime, duke tërhequr kështu gjahtarët e huaj (shih tabelën 3). Edhe në Bosnjë-Hercegovinë dhe Mal të Zi, ujku është objekt gjuetie. Arinjtë mund të gjuhen gjatë sezonit në Republikën Srpska por jo në Federatën e Bosnjë-Hercegovinës. Në Malin e Zi, nga pikëpamja teorike ariu është specie gjuetie por me kufizime (ndalohe për arushat me këlyshë, sezon i mbyllur gjuetie për arinjtë nën dy vjeç), por në praktikë ata nuk janë gjuajtur gjatë njëzet viteve. Disponohen derogime për të mundësuar një kuotë të caktuar të arinjve ose ujqërve që të eliminohen nga popullata në pjesën më të madhe të vendeve, duke përfshirë shtetet anëtare të BE-së, Kroacinë dhe Sloveninë.

Tabela 3: Gjuetia përgjatë Alpeve Dinarike.

Shteti	Ariu	Ujku	Rrëqebullit
Shqipëria	Jo. Vetëm derogime për kafshët problematike.	Jo. Vetëm derogime për kafshët problematike.	Jo
Federata e Bosnjë-Hercegovinës	Jo. Vetëm derogime për kafshët problematike.	Po. Ujku mashkull: 1 janar - 31 dhjetor (nuk ka sezon të mbyllur) Ujkonja dhe këlyshët: 1 korrik - 28/29 shkurt	Jo
Republika Srpska	Objekt gjuetie. Sezoni: 1 tetor -15 maj	Po. Ujku mashkull: 1 janar - 31 dhjetor (nuk ka sezon të mbyllur) Ujkonja dhe këlyshët: 1 korrik - 28/29 shkurt	Jo
Kroacia	Jo. Megjithatë, një kuotë vjetore prej 16% të madhësisë së popullatës është objekt derogimi dhe përfshin eliminimet si masë paraprake, kafshët e vranga automjetet në rrugë dhe	Jo	Jo

	eliminimet si masë ndërhyrjeje.		
Kosova*	Jo	Jo	Jo
Mali i Zi	Pjesë e listës së gjuetisë, por me kuotë zero.	Po. Sezoni: 1 tetor - 28/29 shkurt	Jo
Maqedonia e Veriut	Jo	Po. Sezoni: 1 janar - 31 dhjetor (nuk ka sezon të mbyllur)	Jo
Serbia	Jo. Vetëm derogime për kafshët problematike	Po (me përjashtim të Krahinës Autonome të Vojvodinës), me kuotë të rekomanduar deri në maksimumi 30% të popullatës. Sezoni: 1 korrik – 31 mars	Jo
Slovenia	Jo. Edhe pse një pjesë e popullatës mund të eliminohet sipas një derogimi	Jo. Vetëm derogime për kafshët problematike	Jo

### 4.3 Monitorimi

Një problematikë e veçantë për caktimin e kuotave lidhur me gjuetinë ose derogimet është mungesa e **monitorimit të saktë të shpërndarjes dhe popullatës** në pjesën më të madhe të vendeve (shih tabelën 4). Sllovenia dhe Kroacia përdorin një sërë mënyrash monitorimi, duke përfshirë analizën gjenetike, të cilat parimisht konsiderohen se mundësojnë një përmbledhje të saktë dhe përbushin kërkesat e raportimit të nenit 17 për Direktivën "Për habitatet" (edhe pse disa grupe interesi ende ngrenë shqetësime lidhur me saktësinë e të gjitha përlogaritjeve, veçanërisht për ujkun).

Në të gjitha vendet e tjera, shifrat e popullatave janë përlogaritje të bazuara veçanërisht në vëzhgimet nga gjahtarët, në disa raste duke përfshirë pajisjet telemetrike dhe kamerat-kurth. Në shumicën e rasteve, ekspertët shprehën se metodat e përdorura nuk konsiderohen se ofrojnë shifra të sakta nga pikëpamja shkencore. Në rastet më të këqija (zakonisht për ujkun, për të cilin interesi për gjueti është më i ulët, ndërsa vëzhgimet dhe identifikimi i specieve është më i vështirë), shifrat e nxjerra janë kryesisht supozime (duke qenë se gjahtarët dorëzojnë shifra më të ulëta). Siç përkthehet më poshtë, monitorimi ndërkufitar (me përjashtim të rrëqebullit të Ballkanit) kryhet rrallëherë. Kjo gjë do të thotë se ekziston rreziku i numërimit të dyfishtë ndërmjet vendeve dhe se shifrat midis tyre nuk janë të krahasueshme. Për ta përmbledhur, të intervistuarit e pothuajse të gjitha vendeve theksuan mungesë njohurish shkencore, të personelit të trajnuar dhe të fondeve, të cilat pengojnë integrimin e skemave të monitorimit.

Tabela 4: Monitorimi përgjatë Alpeve Dinarike.

Shteti	Ariu	Ujku	Rrëqebullit
Shqipëria	Përlogaritjet e bazuara te kamerat-kurth, opinionet e ekspertëve dhe ekstrapolimi. Disa monitorime fillestare të të dhënave gjenetike për një rajon të vogël në juglindje të vendit	Përlogaritjet e bazuara te kamerat-kurth, opinionet e ekspertëve dhe ekstrapolimi.	Mbikëqyrje përmes monitorimit të gjurmëve, teknika zë – shënjo - lësho – zë përsëri, mbikëqyrje ekstensive dhe intensive përmes kamerave-kurth
Bosnjë-Hercegovina	Përlogaritjet e bazuara në metodat e numërimit të kafshëve që janë pjesë e listës së gjuetisë, dhe metoda të tjera si p.sh., monitorimi i të dhënave gjenetike	Përlogaritjet e bazuara në metodat e numërimit të kafshëve që janë pjesë e listës së gjuetisë	Përlogaritjet e bazuara në metodat e numërimit të kafshëve që janë pjesë e listës së gjuetisë
Kroacia	Skema e monitorimit që përfshin: monitorimin e të	Skema e monitorimit që përfshin: Kampionet gjenetike (të paplota)	Skema e monitorimit që përfshin: Kamerat-kurth,



Shteti	Ariu	Ujku	Rrëqebullit
	dhënave gjenetike bazuar në mostrat e jashtëqitjeve, regjistrimin e të gjitha rasteve të vdekshmërive dhe dëmeve, kamerat-kurth, numërimet e specieve nga gjahtarët në vendet e ushqyerjes brenda zonës së gjuetisë. Preja e MM-ve nuk është monitoruar	dhe dëmet (ndodhitë në hapësirë dhe kohë të sulmeve të ujqërve ndaj kafshëve shtëpiake), pajisjet telemetrike, kamerat-kurth, mbledhjen e të gjitha shenjave të pranisë së ujqërve duke përdorur kategoritë SCALP (Statusi dhe Ruajtja e Popullatës së Rrëqebullit Alpin)	kampionet gjenetike
Kosova*	Përlllogaritjet e bazuara në të dhënat e administratorëve të zonave të gjuetisë	Përlllogaritjet e bazuara në të dhënat e administratorëve të zonave të gjuetisë	Përlllogaritjet e bazuara në të dhënat e administratorëve të zonave të gjuetisë, fotografitë nga kamerat-kurth
Mali i Zi	Përlllogaritja/mbikëqyrja nga Shoqatat e Gjuetisë dhe shërbimet e ekspertëve në zonat e mbrojtura	Përlllogaritja/mbikëqyrja nga Shoqatat e Gjuetisë dhe shërbimet e ekspertëve në zonat e mbrojtura	
Maqedonia e Veriut	Përlllogaritjet e bazuara në kamerat-kurth dhe ekstrapolimin e mëtejshëm, studim gjenetik (2008)	Përlllogaritjet e bazuara në kamerat-kurth	Monitorimi përmes Programit për Rikuperimin e Rrëqebullit të Ballkanit, mbikëqyrjet në terren
Serbia	Rregullisht përmes projekteve (kamerat-kurth, pajisjet telemetrike, numërimi gjenetik (vetëm në nivel lokal, në Parkun Kombëtar të Tarës))	Përlllogaritjet bazuar në metodat e numërimit të kafshëve që janë pjesë e listës së gjuetisë, si p.sh., mbikëqyrja me pajisje telemetrike, fotografitë nga kamerat-kurth. Disa kampione dhe ekzaminime gjenetike të indeve.	Rregullisht përmes projekteve dhe fotove nga kamerat-kurth
Slovenia	Skema e monitorimit që përfshin: numërimin gjenetik, censusin, monitorimin, modelimin e popullatës, numërimin në vendet e ushqyerjes	Skema e monitorimit që përfshin: numërimin gjenetik, analizën e madhësisë së popullatës dhe prejardhjes gjenetike, metodën e monitorimit të angullimave	Skema e monitorimit që përfshin: kamerat-kurth, kampionet gjenetike

#### 4.4 Planet e menaxhimit

Shumë vende nuk disponojnë **plane menaxhimi**, lidhur me sa u përmend më lart. Kroacia dhe Sllovenia kanë plane menaxhimi (edhe pse aktualisht janë në përditësim), të cilat janë deri në njëfarë mase të koordinuar me njëri-tjetrin (shih tabelën 5).

Serbia dhe Shqipëria kanë përgatitur plane menaxhimi për arinjtë, edhe pse nuk janë vënë akoma në zbatim. Në vende të tjera, planet janë joekzistente dhe mungesa e kapacitetit të monitorimit nënkupton që nuk ka gjasa që ato të përgatiten në të ardhmen. Në të gjitha vendet ku është i pranishëm *Programi për Rikuperimin e Rrëqebullit të Ballkanit*,<sup>25</sup> përbën një përjashtim, pasi disponon monitorim të koordinuar, planifikim të menaxhimit dhe angazhimin e grupeve të interesit.

<sup>25</sup> Faqja e internetit e PPNEA-s: Shoqata e Ruajtjes dhe Mbrojtjes së Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA): Programi për Rikuperimin e Rrëqebullit të Ballkanit: <https://ppnea.org/balkan-lynx-recovery-program/>

Tabela 5: Planet e menaxhimit në Alpet Dinarike.

Shteti	Ariu	Ujku	Rrëqebullit
Shqipëria	Plani i veprimit (2007), nuk ka plan menaxhimi	Jo	Plani i veprimit (2007), nuk ka plan menaxhimi (rrëqebulli i Euroazisë). Zbatuar për rrëqebullin e Ballkanit
Bosnjë-Hercegovina	Jo	Jo	Jo
Kroacia	Po. Përditësuar për herë të fundit në vitin 2019. Plani i menaxhimit zbatohet, plani i veprimit rinovohet çdo vit.	Po. Plani aktual i menaxhimit do të rinovohet	Po. Plani aktual i menaxhimit do të rinovohet
Kosova*	Jo	Jo	Jo
Mali i Zi	Jo	Jo	Jo
Maqedonia e Veriut	Jo	Jo	Plani i menaxhimit për rrëqebullin e Ballkanit disponohet vetëm në një Park Kombëtar (Mavrovë)
Serbia	Jo Ekziston projekt-plani i menaxhimit	Jo Ekziston projekt-plani i menaxhimit	Jo Ekziston projekt-plani i menaxhimit
Slovenia	Po. Planet/strategjitë aktuale do të rinovohen	Po. Planet/strategjitë aktuale do të rinovohen	Po. Strategjia e menaxhimit zbatohet, plani aktual i veprimit do të rinovohet

Angazhimi i grupeve të interesit nuk është mirëzhvilluar në asnjë vend, përveç shteteve anëtare të BE-së. Organizatat e gjuetisë prirën që të jenë të integruara më së miri në menaxhimin e MM-ve, dhe qeveritë bazohen në to për të vënë në dispozicion shifrat lidhur me popullatën. Organizatat bujqësore janë më pak të organizuara dhe të ndara midis tyre, gjë që e bën më të vështirë caktimin e zëdhënësve për të përfaqësuar interesat e tyre. Vetëm në Slloveni, sindikata e fermerëve dhe dhoma e bujqësisë mund të konsiderohen relativisht aktive, duke përfshirë edhe Shoqatën e Bletarisë në Mal të Zi. Edhe pse në shumicën e vendeve ka OJQ që punojnë për ruajtjen e natyrës, shumë prej tyre janë të vogla dhe kanë mungesë kapacitetesh. Megjithatë, nismat ndërkufitare janë ndërmarrë gjerësisht nga OJQ-të dhe shkencëtarët, ndonjëherë edhe me mbështetje ndërkombëtare.

Për shembull, organizata "WWF Adria" ka zhvilluar bashkëpunime në shkallë të gjerë dhe rrjeti i Parqeve të Harkut Dinarik ka bashkuar zonat e mbrojtura në mbarë rajonin. Organizata të tilla si Shoqëria Ekologjike e Maqedonisë (MES), Shoqata e Ruajtjes dhe Mbrojtjes së Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA), Grupi i Veprimit për Përgjegjshmërinë Mjedisore (ERA) në Kosovë\*, Qendra për Mjedisin (nga Bosnjë-Hercegovina, Republika Srpska) dhe Qendra për Mbrojtjen dhe Kërkimin e Shpendëve në Mal të Zi (CZIP) janë aktive në nivel ndërkufitar dhe në aktivitetet ndërkombëtare. Projekti "Bear in Mind" i financuar nga TAIE<sup>26</sup>, ka si synim specifik përmirësimin e angazhimit të grupeve të interesit në Mal të Zi dhe Bosnjë-Hercegovinë.

#### 4.5 Kërcënimet kryesore ndaj popullatave të mishngrënësve të mëdhenj

Krahas mungesës së provave shkencore dhe monitorimit të koordinuar, një sërë **kërcënimesh ndaj specieve të MM-ve** janë të pranishme në rajon, edhe pse monitorimi i

<sup>26</sup> Projekti "Bear in Mind": <http://bearinmind.me/about-us/>



ndikimit shpeshherë nuk është prezent, kështu që tabela e mëposhtme bazohet në opinionet e ekspertëve (shih tabelën 6).

Tabela 6: Kërcënimet kryesore.

Shteti	Ariu	Ujku	Rrëqebullit
Shqipëria	gjuetia pa leje, kapja	gjuetia pa leje (pak të dhëna)	degradimi i habitatit
Bosnjë-Hercegovina	gjuetia pa leje, degradimi i habitatit, infrastruktura, shqetësimet, arinjtë problematikë	ndjekja, gjuetia pa leje	gjuetia pa leje
Kroacia	raporti meshkuj/femra, arinjtë problematikë (që shfaqin sjellje miqësore ndaj njerëzve), infrastruktura, shqetësimet, turizmi	gjuetia pa leje dhe ndjekja, pranimi nga qytetarët, mungesa e presë natyrore (në nivel vendor, në jug të Kroacisë), degradimi i habitatit (duke përfshirë braktisjen), ujqërit që janë mësuar me prani njerëzore (lidhet me asgjësimin e karkasave), kryqëzimi i racave	gjenetika/endogamia
Kosova*	shqetësimet (menaxhimi i pyjeve), gjuetia pa leje, menaxhimi i mbetjeve	gjuetia pa leje, shqetësimet, turizmi	gjuetia pa leje, shqetësimet, turizmi
Mali i Zi	gjuetia pa leje, shqetësimet, degradimi i habitatit, turizmi	gjuetia pa leje, konkurrenca për prenë (konfliktet me gjahtarët), degradimi i habitatit	nuk ka
Maqedonia e Veriut	gjuetia pa leje, degradimi i habitatit, kurthet	gjuetia pa leje, gjahtarët	konkurrenca për prenë, endogamia, ndjekja/gjuetia pa leje, degradimi i habitatit
Serbia	degradimi i habitatit, infrastruktura, aksesueshmëria e presë, gjuetia pa leje	degradimi i habitatit, aksesueshmëria e presë, kryqëzimi i racave	gjenetika/endogamia
Slovenia	pranimi nga qytetarët, mediatizimi, gjuetia, degradimi i habitatit dhe konektiviteti	pranimi nga qytetarët, mediatizimi, ujqërit që janë mësuar me prani njerëzore, degradimi i habitatit, aksidentet rrugore	gjenetika/endogamia, gjuetia pa leje, aksidentet rrugore

Gjuetia e disa specieve të MM-ve konsiderohet se përbën kërcënim në vendet ku lejohet, me mendimin se ndikimet nuk janë matur në nivelin e mjaftueshëm. Me fjalë të tjera, edhe kur gjuetia është e mirërregulluar, ajo pa leje mbetet një problematikë e konsiderueshme në disa prej vendeve në fjalë, qoftë në formën e qitjeve, helmimeve apo kurtheve, në përpjekje për të reduktuar popullatën në vendndodhje të caktuara. Kjo gjë prek të gjitha speciet. Në Shqipëri, ekspertët vënë në pah ndikimin e praktikës së kapjes së këlyshëve të ariut për përdorim privat dhe vrasjen e arushave, pra nënave të tyre (Figura 6). Ky perceptim publik i MM-ve dhe mbështetja ndaj gjuetisë pa leje, lidhet qartazi me konfliktet e përshkruara më poshtë. Kërcënimet shtesë për të gjitha speciet përfshijnë humbjet e habitateve prej zhvillimeve infrastrukturore.

Në të gjitha vendet, planifikimi infrastrukturor në shkallë të gjerë mund të përbëjë një rrezik

serioz me kalimin e viteve,<sup>27</sup> si dhe shqetësime, shpeshherë për shkak të zhvillimit të shtuar të turizmit. Për më tepër, menaxhimi i dobët i mbetjeve mund të çojë në shtimin e kontakteve ndërmjet njerëzve dhe arinjve, duke zhvilluar me gjasa sjellje problematike (sjellje të kushtëzuara nga ushqimi) që rrjedhimisht rezulton në eliminimin e tyre. Ushqyerja suplementare nga gjahtarët mund të ndikojë në sjelljen e arinjve dhe shtimin e riprodhimit të tyre, edhe pse gjahtarët argumentojnë se kjo gjë i mban arinjtë larg fshatrave dhe tokave bujqësore. Mungesa e presë natyrore u evidentua si faktor kontribues në varësinë e ujërve grabitqarë ndaj bagëtive në disa zona të Kroacisë dhe Maqedonisë së Veriut. Kryqëzimi i ujërve me qentë konsiderohet se përbën kërcënim në Kroaci, Slloveni dhe Serbi, por kjo gjë nuk është studiuar në vende të tjera. Për rrëqebullin, endogamia konsiderohet si kërcënim më serioz, pasi popullatat mbeten të vogla dhe të izoluara.



Figura 6. Në anëtare e ekipit të ndërhyrjes duke liru arin nga kurthi i një gjahtari pa leje (Autori i fotografisë: Josp Kusak).

---

<sup>27</sup> Janë planifikuar mbi 580 milionë euro si burime shtesë për zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës së mbështetur nga BE-ja, në rajonin e Ballkanit Perëndimor, WBIF (Kudri i Investimeve në Ballkanin Perëndimor) - [https://ec.europa.eu/neighborhood-enlargement/news/eu-starts-implementing-economic-and-investment-plan-western-balkans-2020-12-17\\_en](https://ec.europa.eu/neighborhood-enlargement/news/eu-starts-implementing-economic-and-investment-plan-western-balkans-2020-12-17_en); Transporti - <https://w.bif.eu/sectors/transport>; Plani financiar i BE-së për Ballkanin Perëndimor - 30 miliardë euro gjatë shtatë viteve, <https://www.euractiv.com/section/enlargement/opinion/integrity-compliance-in-western-balkans-infrastructure-projects/>; Konektiviteti dhe investimet në infrastrukturë në Ballkanin Perëndimor, [https://w.bif.eu/storage/app/media/Library/6.%20Connectivity%20Agenda/brochure\\_wb\\_connectivity\\_agenda\\_en.pdf](https://w.bif.eu/storage/app/media/Library/6.%20Connectivity%20Agenda/brochure_wb_connectivity_agenda_en.pdf), [https://www.eib.org/attachments/efs/infrastructure\\_investment\\_in\\_the\\_western\\_balkans\\_en.pdf](https://www.eib.org/attachments/efs/infrastructure_investment_in_the_western_balkans_en.pdf); Projekt-plani hapësinor i Serbisë për vitet 2021-2035 - një hartë për infrastrukturën rrugore: [https://www.mgsi.gov.rs/sites/default/files/03aREF\\_PPRS\\_saobracaj.jpg](https://www.mgsi.gov.rs/sites/default/files/03aREF_PPRS_saobracaj.jpg), dhe teksti i plotë i planit: <https://www.mgsi.gov.rs/sites/default/files/PPRS%20Nacr.pdf>

## 4.6 Konfliktet kryesore

Për sa i përket **konflikteve të evidentuara më së shumti**, ujku mbetet specia më konfliktuale dhe mbart këndvështrimet më negative nga publiku (shih Tabela 7). Kjo gjë është pothuajse universale për shkak të ngrënies së bagëtive dhe në disa raste, ngrënies së qenve të gjahut. Frika nga ujqërit është përmendur si problematikë vetëm nga disa të intervistuar në Bosnjë-Hercegovinë dhe Slloveni. Disa të anketuar theksuan se mbarështuesit e bagëtive janë të mësuar me ujqërit dhe zbatojnë tashmë masa mbrojtëse. Për shembull, në Shqipëri, konfliktet lidhur me ngrënien e bagëtive konsiderohen relativisht të ulëta pasi barinjët shoqërojnë tufën në çdo kohë.

Ariu është një specie disi më pak konfliktuale në rajon, megjithatë shkatërrimi i koshereve të bletëve dhe ngrënia e bagëtive mbeten burim tensioni. Sjellja e arinjve problematikë (ushqyerja me mbetje, arinj të që zbresin në fshat etj.) përbën shqetësim në disa vende, por kjo gjë paraqitet e kufizuar gjeografikisht. Arinjtë problematikë, u konsideruan një shkak madhor konflikti vetëm në Kroaci dhe Slloveni. Rrëqebulli është shumë më pak konfliktual (edhe për shkak të numrit të ulët të popullatës), por ata shfaqin sjellje konkurruese me gjahtarët për pre të rralëherë kafshët shtëpiake bëhen pre e tyre.

Tabela 7: Konfliktet lidhur me praninë e MM-ve.

Shtetet	Ariu	Ujku	Rrëqebullit
Shqipëria	dëme	dëme, konflikte gjuetie	pak konflikte
Bosnjë-Hercegovina	dëme, frikë	dëme, konflikte gjuetie, frikë nga ujqërit që janë mësuar me prani njerëzore	pak konflikte
Kroacia	probleme me arinjtë që shfaqin sjellje miqësore ndaj njerëzve	dëme, frikë, konflikte gjuetie	konflikte gjuetie
Kosova*	dëme	dëme	pak konflikte
Mali i Zi	dëme, konkurrencë për produkte pyjore	dëme	pak konflikte
Maqedonia e Veriut	dëme, frikë	dëme	pak konflikte
Serbia	dëme, frikë	dëme, konflikte gjuetie, frikë	pak konflikte
Sllovenia	dëme, frikë	dëme	konflikte gjuetie, dëme (minimale)

## 4.7 Mbrojtja dhe kompensimi i bagëtive

Për sa i përket **përgjigjeve për reduktimin e konfliktit**, në shumë vende kompensimi për dëmet ekziston teorikisht (shih fig. 7), i cili mbulohet nga shoqatat e gjuetisë (në rastet kur MM-të janë objekt gjuetie) ose nga ministritë e bujqësisë, mjedisit, autoritetet vendore ose administratorët e zonave të mbrojtura (shih tabelën 8).



Figura 7: Ruajtja e bagëtive nga qentë e stanit (Autori i fotos: Djuro Huber).

Tabela 8: Kompensimi dhe mbrojtja.

Shteti	Rregullat e kompensimit dhe parandalimit	Pagesat e kompensimit dhe parandalimit (kur dihen)
Shqipëria	Qentë e stanit, barinjët, rrethimet, gardhimet gjatë natës si masa parandaluese, por jo të financuara nga shteti.	Nuk ka pagesa
Bosnjë-Hercegovinë	RS: Ekzistojnë masat e kompensimit (rimbursim 100%), me masa parandaluese si kusht paraprak për ariun dhe rrëqebullin, ndërkohë që nuk ka masa kompensuese për ujkun. Kostoja ndahet midis Ministrisë së Bujqësisë, administratorit të zonës së gjuetisë dhe bashkisë. Fed. e BH-së: Ekziston kompensimi, me masa mbrojtëse si kusht paraprak	Ministria e Bujqësisë e regjistron tarifën e kompensimit, por nuk disponohet për publikun
Kroacia	Kompensimi: ekziston, me masa parandaluese si kusht paraprak Ariu: kompensimi mbulohet nga gjahtarë të pajisur me leje Ujku: kompensimi mbulohet nga Ministria e Mjedisit Në praktikë, të gjitha dëmet janë të kompensueshme (brenda 1 viti)  Masat parandaluese mund të financohen sipas FEBZhR-së (Masa 4.4).	Kompensimi për vitin 2018 U shpenzuan: 1 658 948,00 Kuna Kroate (221 193 euro), për 1218 raste Parandalimi Është planifikuar një shumë mesatare prej 900 000 euro për masën (6,5 milionë euro për periudhën e financimit 2014-20) por përfshin një sërë masash të tjera
Kosova*	Ekziston skema e kompensimit, por nuk zbatohet	Nuk zbatohet
Mali i Zi	Ekziston kompensimi, me masa parandaluese si kusht paraprak. Komisioni vlerëson normën e kompensimit.	Kompensimi vihet rralëherë në praktikë
Maqedonia e Veriut	Ekziston kompensimi për arinjët, por jo për rrëqebullin ose ujkun	Kompensimi është mesatarisht 600 000 euro në vit (2013-2018) <sup>28</sup>
Serbia	Ekziston kompensimi, me masa parandaluese si kusht paraprak. Komisioni vlerëson normën e kompensimit	Kompensimi vihet rralëherë në praktikë
Slovenia	Ekziston kompensimi, me masa parandaluese si kusht paraprak.	Kompensimi Për arinjët: mesatarisht 86 500 euro në vit (865 000 euro ndërmjet viteve 2010-19)

<sup>28</sup> Faqja e lajmeve "Prism" (2018) Bear sued, the state pays: <https://prizma.mk/mechkite-tuzheni-drzhavata-plaka/>



Shteti	Rregullat e kompensimit dhe parandalimit	Pagesat e kompensimit dhe parandalimit (kur dihen)
	Parandalimi financohet nga fondet kombëtare, FEBZHR, projektet e programit LIFE (p.sh. "LIFE Slow olf" për ruajtjen afatgjatë të ujqërve, "LIFE DINALP BEAR" për mbrojtjen e arinjve në Alpet Dinarike)	Për ujqërit: mesatarisht 172 000 euro në vit (1,72 milionë euro ndërmjet viteve 2010-19) Shuma e masave të parandalimit për vitin 2019 237 428 euro të ndara si vijon: - Për gardhet elektrike 130 798 euro - Për qentë e stanit 88 608 euro - Për barinjte 18 022 euro

Në Slloveni dhe Kroaci, disponohen sistemet funksionale të kompensimit dhe mbështetje për marrjen e masave mbrojtëse (të cilat duhet të jenë të disponueshme për marrjen e kompensimit, Figura 7). Në Bosnjë-Hercegovinë dhe Maqedoni të Veriut ekzistojnë masat e kompensimit për dëmet nga arinjte, por jo për dëmet nga ujqërit. Në Kosovë\* kompensimi ekziston për dëmet e shkaktuara nga ujqërit por jo nga arinjte (edhe pse rrallëherë shlyhen), ndërsa në Mal të Zi ekziston për të dyja speciet. Në Shqipëri nuk ekzistojnë skemat e kompensimit (por siç u përmend më lart, ka më shumë gjasa që barinjte të jenë mësuar me praninë e MM-ve, përkundrajt zonave të tjera).

Disa vende po marrin masa edhe për të vënë në dispozicion ekipet e ndërhyrjes (EN-të) për reagime të menjëhershme në rastet e incidenteve të lidhura me arinjte. Kroacia dhe Sllovenia disponojnë ekipe funksionale dhe Republika Srpska po ngre një ekip. Megjithatë, në disa vende mungojnë burimet për kryerjen e detyrave, për shembull në Mal të Zi, mungesa e një automjeti të përshtatshëm për përballimin e incidenteve përbënte problem, përfshirë këtu edhe fondet dhe personelin e trajnuar.

#### 4.8 Nismat ekzistuese ndërkuftare

Të intervistuarit ofruan informacione edhe mbi **projektet ekzistuese ndërkuftare** (shih tabelën 9). Në Kroaci dhe Slloveni ekzistojnë bashkëpunime shumë të mira, afatgjata midis ekspertëve dhe OJQ-ve. Këta aktorë janë gjithashtu të angazhuar në mënyrë aktive me qeveritë përkatëse dhe shkëmbimet qeveritare janë promovuar në kuadër të projekteve të tilla si projekti ndërrajonal i bashkëpunimit Interreg "Carnivora Dinarica".

Kroacia dhe Sllovenia bashkëpunojnë edhe me vendet e tjera të BE-së, veçanërisht me vendet Alpine si p.sh., Italia dhe Austria përmes projekteve të profilit të lartë, të bashkëfinancuar nga LIFE dhe të menaxhuara nga Shërbimi Pyjor i Sllovenisë (projektet "LIFE DINALP Bear" dhe "LIFELYNX") dhe përmes partneriteteve ndërkuftare në shkallë të gjerë ("LIFE EUROLARGE CARNIVORES, LIFE SWIPE"). Programi afatgjatë për Rikuperimin e Rrëqebullit të Ballkanit ka luajtur një rol të rëndësishëm për mbledhjen e ekspertëve përtej kufijve (Shqipëria, Kosova\* dhe Maqedonia e Veriut) me qëllimin specifik shpëtimin e rrëqebullit të Ballkanit. Ndërsa ndërmjet vendeve të tjera, bashkëpunimi bazohet kryesisht tek kontaktet individuale dhe është më i thjeshtë ose më i vështirë në varësi të marrëdhënieve ekzistuese.

OJQ-të nga Kroacia, Mali i Zi dhe Republika Srpska bashkëpunojnë në mënyrë efikase, duke përfshirë edhe projektin "Bear in Mind". Megjithatë, situata në Bosnjë-Hercegovinë kërkon vëmendje të veçanti për shkak të ndarjes rajonale të vendit<sup>29</sup>. Çdo entitet mban përgjegjësi për menaxhimin e MM-ve, dhe teksa ekziston edhe një organ mjedisor ndërmjet entiteteve, të intervistuarit e cilësuan si të vështirë bashkëpunimin ndërmjet ministrive. Kjo gjë

<sup>29</sup> Bosnjë-Hercegovina (BH) është e ndarë në rajone, me entitetet e mëposhtme: Federata e Bosnjë-Hercegovinës (FBH me 16 kantone), Republika Srpska (RS), dhe Distrikti i Bërçkos.

vështirëson edhe bashkëpunimin e vendeve të tjera me Bosnjë-Hercegovinën në nivel kombëtar. Qartazi, edhe marrëdhëniet politike specifike midis vendeve, luajnë rolin e tyre e.

Tabela 9: Projektet dhe programet në rajon.

Emri	Data	Shtetet e përfshira	Përshkrimi	Faqja e internetit
Programi për Rikuperimin e Rrëqebullit të Ballkanit	2006-e në vazhdim	AL, MZ, KO, CH, DE	Programi synon shpëtimin e rrëqebullit të Ballkanit, pasi është në rrezik kritik për zhdukje. Vizioni i këtij programi është "ekzistenca afatgjatë e një popullate të mirëfilltë të rrëqebullit të Ballkanit në hapësirat e shpërndarjes historike të tij, në përputhje me nevojat e komuniteteve lokale dhe me mbështetjen e tyre".	<a href="https://ppnea.org/balkan-lynx-recovery-program/">https://ppnea.org/balkan-lynx-recovery-program/</a>
"Life Dinalp bear"	07.2014-06.2019	SI, HR, AT, IT	Përmirëson monitorimin e popullatës, redukton konfliktet dhe përmirëson bashkëekzistencën, promovon shpërndarjen natyrore të arinjve në Alpe	<a href="https://dinalpbear.eu/home-page-1/">https://dinalpbear.eu/home-page-1/</a>
"Life lynx"	07.2017-03.2024	SI, HR, IT, RO, SK	Ka për qëllim të shpëtojë nga zhdukja popullatën e rrëqebullit të Alpeve Dinarike-Juglindore dhe ta ruajë atë në planin afatgjatë përmes rikuperimeve të popullatës, angazhimit të grupeve të interesit, monitorimit	<a href="https://www.lifelynx.eu/">https://www.lifelynx.eu/</a>
"LIFE EURO LARGE CARNIVORES"	09.2017-02.2022	DE, AT, CH, FI, FR, DE, HU, IT, PL, RO, ES, HR, SLO, NO	Përmirëson komunikimin dhe bashkëpunimin ndërkufitar për mishngrënësit e mëdhenj. Organizata "WWF Adria" ka koordinuar shumë aktivitete në rajon.	<a href="https://www.eurolargecarnivores.eu/en/">https://www.eurolargecarnivores.eu/en/</a>
Mbrojtja e ariut të murrmë në Alpet Dinarike	01.2018-12.2020	BH <sup>31</sup> , ME	Synon të zhvillojë një plan ndërkufitar për monitorimin dhe menaxhimin e arinjve ndërmjet shteteve të përfshira.	<a href="https://ec.europa.eu/environment/nature/conservation/species/carnivores/pdf/181106Budva_15_B BPD_LC%20Aleksandar%20Perovic.pdf">https://ec.europa.eu/environment/nature/conservation/species/carnivores/pdf/181106Budva_15_B BPD_LC%20Aleksandar%20Perovic.pdf</a>
Projekti ndërrajonal i bashkëpunimit Interreg "Carnivora Dinarica"	09.2018-08.2021	SI, HR	Synon vendosjen e bashkëpunimit ndërinstitucional, harmonizimin e studimeve të popullatave të ujçërve dhe rrëqebujve, analizën e përbashkët të ndërlidhjes së habitateve, vlerësimin e përbashkët të shërbimeve në ekosisteme nga mishngrënësit e mëdhenj, si dhe testimin dhe zbatimin e masave të mbrojtjes për bagëtitë.	<a href="https://www.carnivoradinarica.eu/en/large-carnivores/wolf/biology-ecology-and-behaviour/">https://www.carnivoradinarica.eu/en/large-carnivores/wolf/biology-ecology-and-behaviour/</a>
"Bear in Mind"	11.2019-05.2022	BH, ME	Projekti synon të fuqizojë dhe zhvillojë kapacitetet e organeve administrative të zonave të mbrojtura dhe OJQ-ve mjedisore në Mal të Zi dhe Bosnjë-Hercegovinë, si dhe të përmirësojë nivelin e pjesëmarrjes në proceset e	<a href="http://bearinmind.me/about-us/">http://bearinmind.me/about-us/</a>

Emri	Data	Shtetet e përfshira	Përshkrimi	Faqja e internetit
			politikëbërjes.	
Projekti ndërrajonal Interreg "Adrion DINALPCONNECT"	3.2020-8.2022	SI, HR, AL, BH, GR, IT	Synon të forcojë bashkëpunimin sektorial dhe ndërkombëtar për përmirësimin e ndërlidhjes ekologjike në mbarë Malet Dinarike, duke i lidhur ato me Alpet. Lidhjet ndërkufitare midis zonave të Natura 2000 dhe zonave të mbrojtura, duke u fokusuar te speciet dhe habitatet me prioritet.	<a href="https://dinalpconnect.adrioninterreg.eu/">https://dinalpconnect.adrioninterreg.eu/</a>
"LIFE SWIPE"	09.2020-08.2023	BH, BG, HR, IT, PL, RO, SK, RS, ES, UA	Synon të parandalojë dhe të reduktojë gradualisht krimet ndaj botës së egër, duke përfshirë gjuetinë pa leje të MM-ve përmes respektimit në masë më të madhe të legjislacionit të BE-së për mjedisin dhe rritjes së numrit të shkeljeve të ndjekura penalisht	<a href="https://www.wwfadhria.org/what_we_do/all_initiatives/life_swipe/">https://www.wwfadhria.org/what_we_do/all_initiatives/life_swipe/</a>

Krahas Marrëveshjes së Budvës (shih hyrjen), edhe një sërë **nismash rajonale** në të shkuarën kanë synuar vendosjen e bashkëpunimit në nivel rajonal (shih tabelën 10).

Asnjëra prej tyre nuk i ka pasur në fokus specifik mishngrënësit e mëdhenj, por disa nga objektivat e tyre kanë qenë plotësuese. Ekipi i projektit po përpilon një bazë të dhënash<sup>30</sup> për këto projekte dhe nisma ekzistuese ndërkuftare për të vijuar më tej aktivitetin e platformës.

Tabela 10: Nismat në rajon

Emri	Data	Shtetet përfshira	Përshkrimi	Faqja e internetit
Nisma për Harkun Dinarik	2008-e në vazhdim	AL, BH, HR, ME, SE, SI	Është një kuadër i gjerë bashkëpunimi që mbledh së bashku partnerët aktivë në rajon me një portofol të larmishëm projektesh dhe nismash që synojnë sigurimin e ruajtjes afatgjatë dhe zhvillimin e qëndrueshëm në këtë pjesë të Evropës.	<a href="https://www.panda.org/discover/our_focus/biodiversity/protected_areas/pa4lp/dinaric_arc/">https://www.panda.org/discover/our_focus/biodiversity/protected_areas/pa4lp/dinaric_arc/</a>
Rezoluta për Alpet Dinarike	03.2011	AL, ME, HR, KO, MZ, SI (pritet të nënshkruhet edhe nga BH)	Rezoluta është miratuar nga përfaqësuesit e vendeve Dinarike për zhvillim të qëndrueshëm në vargmalet Dinarike. Kjo nismë është ndërmarrë nga Sllovenia në Konferencën për Alpet Dinarike, e mbajtur në të njëjtën kohë me Konferencën e 11-të për Alpet.	<a href="https://www.alpconv.org/fileadmin/user_upload/Organization/Partners/Dinaric_Arc_Resolution.pdf">https://www.alpconv.org/fileadmin/user_upload/Organization/Partners/Dinaric_Arc_Resolution.pdf</a>
Marrëveshja e Budvës	11.2018	AL, BH, HR, KO, ME, MZ, SRB, SI, BG, GR	Marrëveshja u arrit në seminarin rajonal të platformës së BE-së për MM-të, për bashkëpunim lidhur me ngritjen e Platformës Dinarike për ruajtjen dhe menaxhimin e mishngrënësve të mëdhenj.	<a href="https://ec.europa.eu/environment/nature/conservation/species/carnivores/pdf/181106Budva_LCP_Workshop%20statement-EN.pdf">https://ec.europa.eu/environment/nature/conservation/species/carnivores/pdf/181106Budva_LCP_Workshop%20statement-EN.pdf</a>

<sup>30</sup> Shih bazën e të dhënave të ekipit të projektit këtu:

<https://docs.google.com/spreadsheets/d/1vXH0BW6H1oYXceh90d6yIXRuQ87y1fS5/edit#gid=1209534236>



## 5 Diskutime, hapat pasardhës dhe perspektiva

Përmbledhja e mësipërme paraqet qartazi nevojën e ngritjes së kapaciteteve dhe të shkëmbimit lidhur me monitorimin dhe menaxhimin e MM-ve. Sllovenia dhe Kroacia kanë deri diku (me disa përjashtime) një sistem të zhvilluar për planifikimin e menaxhimit dhe monitorimin, për shkak të shtysës për të përmbushur kërkesat e Direktivës së BE-së "Për habitatet", edhe pse në shtojcën 4 tregohet se edhe përpara kësaj, monitorimi kryhej në kuadër të kërkesave të raportimit për Konventën e Bernës dhe CITES. Fakti që planet e menaxhimit janë zhvilluar në disa shtete por kanë ngecur në fazën e autorizimit ose zbatimit, tregon se ekziston dëshira për koordinimin e qasjeve për ruajtjen dhe menaxhimin e MM-ve, por disa pengesa të tilla si aftësitë përkatëse, qartësitë rreth kompetencave, shqetësimet nëse kostot do të jenë shumë të larta dhe mungesa e vullnetit politik, kanë paraqitur vështirësi në zgjidhje.

Ky raport ofron një paraqitje të shkurtër mbi të cilën mund të bazohen diskutimet e ardhshme në kuadër të platformës. Intervistat janë një burim i vlefshëm informacioni, që mund të plotësohet dhe verifikohet përmes diskutimeve në grupe.

Tematikat e mëposhtme mund të trajtohen më në detaje në formatet e ndryshme të përfshira në projekt.

Tabela 11: Hapat pasardhës për tematikat e platformës.

Tematika	Problematika	Mënyrat e trajtimit të problematikës
Monitorimi i saktë ndërkufitar	Monitorimi i saktë sipas standardeve të Direktivës "Për habitatet" ekziston vetëm në Slloveni dhe Kroaci. Koordinimi përtej kufijve ndodh rrallëherë. Ka mungesë kapacitetesh në shumë vende, për sa i përket burimeve dhe personelit, dhe nevojiten përpjekje të konsiderueshme për të mbështetur sistemet e monitorimit dhe për të nxitur bashkëpunimin.	Një nga tematikat kryesore të platformës mund të jetë krahasimi dhe diskutimi i skemave të monitorimit dhe dakordësia lidhur me nevojën për monitorim aty ku nuk ekziston, si dhe harmonizimi i teknikave dhe proceseve, aty ku disponohet monitorimi. Mund të mbështeteni në përvojat e Kroacisë dhe Sllovenisë lidhur me projektet e LIFE-it, të cilat kanë përkrahur zhvillimin e monitorimit. Nëse njihet nevoja për monitorim, mund të zhvillohen projekte të përbashkëta midis shteteve dhe të nxiten mësimet e ndërsjella mes ekspertëve, si dhe të dakordësohet për standardet minimale të monitorimit <sup>31</sup> . Nevoja për bashkëfinancim për pjesën më të madhe të skemave të financimit përbën një sfidë të konsiderueshme.
Krijimi i një plani për menaxhimin ndërkombëtar	Planifikimi i menaxhimit mungon në shumë shtete. Nuk ka kapacitete dhe ide për mënyrën e krijimit të proceseve të planifikimit të menaxhimit dhe as për zbatimin e tyre.	Edhe kjo do të ishte një temë kyçe për takimet e platformës. Shembujt mund të kërkohen nga vendet e përfshira dhe nga vendet e tjera të BE-së. <sup>32</sup>
Konsultimi me grupet e interesit dhe angazhimi i tyre	Shpeshherë, grupet e interesit nuk angazhohen në proceset e planifikimit (kur ato ekzistojnë). Kjo gjë mund të shkaktojë zhgënjim lidhur me proceset dhe mungesë	Planifikimi i menaxhimit duhet të bëhet me përfshirjen e grupeve të interesit. Platformat e BE-së shërbejnë si burim i pasur njohurish, shumë prej të cilave janë krijuar po ashtu në vitet e fundit.

<sup>31</sup> p.sh. standardet e përbashkëta të monitorimit për Poloninë dhe Gjermaninë: Reinhardt I., Kluth G., Nowak S., Myslajek R.W. (2015): Standards for the monitoring of the Central European wolf population in Germany and Poland. BfN-Skripten 398. Kopja pa pagesë e disponueshme në [www.bfn.de/skripten](http://www.bfn.de/skripten)

<sup>32</sup> p.sh. përmes rishikimit të menaxhimit: Reinhardt I., Kluth G., Nowak S., Myslajek R.W. (2013): A review of wolf management in Poland and Germany with recommendations for future transboundary collaboration. BfN-Skripten 356. Gjermani / Bundesamt für Naturschutz. Bon.

Tematika	Problematika	Mënyrat e trajtim it të problematikës
	besimi mbi mënyrën se si qeveria e organizon menaxhimin.	Në takimet e platformës mund të paraqiten shembuj, të cilat mund të diskutohen më hollësisht me përfaqësuesit e shoqërisë civile.
Skemat e kompensimit dhe të mbrojtjes	Ekziston një konsensus i përgjithshëm që masat e kompensimit dhe parandalimit janë të favorshme, por funksionimi i këtyre skemave paraqet disa problematika të konsiderueshme.	Arsyet e këtyre problemeve mund të trajtohen më në hollësi me administratorët dhe përfaqësuesit e interesave të sektorit të blegtorisë. Masat parandaluese (qentë e stanit, barinjë, rrethimet) dhe mënyrat për mbështetjen e tyre, përbëjnë një tematikë diskutimi të rëndësishme lidhur me bashkëjetesën. Përdorimi i programeve të BE-së për zhvillimin rural mund të shqyrtohet më tej, duke përfshirë edhe përdorimin e mundshëm të Instrumentit të Ndhmës së Para-Anëtarësimit për Zhvillimin Rural (IPARD)
Reduktimi i ndërveprimeve me arinjtë problematikë	Arinjtë problematikë përbëjnë shqetësim në shumë shtete, por për këtë gjë janë testuar edhe disa zgjidhje.	Në BE dhe në disa prej vendeve të përfshira janë testuar një sërë masash, duke filluar nga ekipet e ndërhyrjes, te menaxhimi i qarkullimit e deri te menaxhimi i mbetjeve. Ato mund të paraqiten dhe të hidhen për diskutim me pjesëmarrësit, duke konsideruar gjasat e marrjes së masave të njëjta në shtete të ndryshme.
Koordinimi në shkallë të gjerë dhe shkëmbimi për menaxhimin ndërkombëtar	Edhe pse ekzistojnë shembuj për koordinimin dypalësh ose trepalësh, nuk ekziston një kuadër gjithëpërfshirës për rajonin, dhe për këtë arsye qasjet ndaj menaxhimit të MM-ve ndryshojnë ndjeshëm.	Ky është qëllimi kyç i krijimit të platformës. Disponohen një sërë modelesh nga rajonet e tjera lidhur me bashkëpunimin për MM-të (p.sh. Platforma e BE-së) ose bashkëpunimin në nivel rajonal (Konventa e Alpeve apo ajo e Karpateve). Anëtarët e platformës mund të diskutojnë një sërë opsionesh të ndryshme, për të gjetur mjetet për bashkëpunim afatgjatë.

Ky raport u paraqit në mbledhjen e parë të anëtarëve të mundshëm të platformës, i cili u mbajt në Slloveni në datat 16-17 nëntor 2021.